Vizita në repartin e mbyllur u realizua në tremujorin e parë të vitit me fokus krahun e 3, 4, 7 dhe të ashtuquajturën "Ambulancë". Situata e hasur ishte seriozisht shqetësuese, shkaku i së cilës u shënua se situata në këto krahë mund të renditet lirisht nën termin e trajtimit çnjerëzor dhe degradues¹⁵. Konkretisht, u shënuan vërejtje serioze lidhur me gjendjen material dhe kushtet tjera në të cilat jetojnë të dënuarit në këtë pjesë të entit ndëshkues-korrektues. Mbipopullimi ishte i dukshëm sepse të dënuarit flinin në dysheme të korridorit në krahë të caktuar, ndërsa 14 ose 15 persona qëndronin në dhoma të caktuara në shtretër të improvizuar në katër kate. Si për kujtesë, Rregullat Evropiane të Burgjeve¹⁶ kërkojnë 4m2 hapësirë individuale në banesa të përbashkëta ose 6m2 në banesa të pavarura si standard minimal për strehimin e personave të privuar nga liria.

Seriozisht shqetësuese është edhe gjendja me kujdesin shëndetësor, e cila në radhë të parë vjen si pasojë e mungesës së një numri të mjaftueshëm të personelit mjekësor, për çka shpesh thirret edhe Ndihma e shpejtë mjekësore, sidomos pasdite. Për shkak të volumit të rritur të punës, punonjësit ekzistues shëndetësorë nuk janë në gjendje t'u përgjigjen nevojave të të dënuarve, kështu që numri i ankesave nga ana e tyre është i lartë.

Vizitën e dytë në INK-ENK Idrizovë ekipi i MPN-së e realizoi në tremujorin e dytë të vitit, përkatësisht menjëherë pas shpalljes së Gjendjes së krizës, e cila më datën 06.06.2023 me Vendim¹⁷ të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut konstatoi ekzistimin e gjendjes së

¹⁴ Raporti i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2023, në dispozicion në: <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657> (Qasur më datën: 20.03.2024)

¹⁵ Më shumë për gjendjen e hasur përmban Raporti vjetor i ekipit të MPN-së, në dispozicion në: <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/NPM-dokumenti/2022/NPM%20Godisen%20izvestaj-2022-Mk-Alb-Ang.pdf> (Qasur më datën: 20.01.2024)

¹⁶ Rregullat Evropiane të burgjeve – Këshilli i Evropës, i disponueshëm në <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae> (Qasur më datën: 26/05/2023)

¹⁷ Vendimi për ekzistimin e gjendjes së krizës në një pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 41-5397/3, i datës 06.06.2023 (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 116, e datës 07.06.2023)

krizës në një pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe kjo, në zonën e Komunës së Gazi Babës, ku Institucioni ndëshkues-korrektues dhe Enti ndëshkues-korrektues Idrizovë ushtrojnë kompetencën e tyre. Gjendja e krizës është shpallur me qëllim të parandalimit të kërcënimeve të sigurisë dhe forcimit të sigurisë së institucionit, për këtë arsye në sigurimin e objektit janë përfshirë përkohësisht pjesëtarë të Ministrisë së punëve të brendshme (MPB) dhe Ushtrisë.

Kështuqë, pjesëtarët e MPB-së dhe të Ushtrisë, pa pasur asnjë pike kontakti me të dënuarit, sigurojnë brezin e jashtëm të INK-ENK Idrizovë, Ushtria siguron karaulat, ndërsa pjesëtarët e MPB-së ndihmojnë për bastisje, inspektim dhe skenim të bagazhit.

Lidhur me situatën e krizës, më vonë më datën 19 korrik të vitit 2023, në bashkëpunim me Shoqatën e juristëve të rinj të Maqedonisë (SHJRM), u organizua një forum tematik, ku morën pjesë përfaqësues nga Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Qendra për menaxhim me kriza, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve dhe organizatat civile. Në forum, përveç tjerash, u konkludua se është i domosdoshëm miratimi nga ana e Kuvendit për vazhdimin e situatës së krizës dhe nevoja e përfshirjes së përfaqësuesve të MPN-së dhe organizatave civile në seancat e Shtabit kryesor (SHK) për menaxhimin e krizës me qëllim të informimit të drejtpërdrejtë për zbatimin e planeve operative për tejkalimin e situatës së krizës. Në këtë kuptim, më pas, në takimet e SHK për menaxhimin e krizave merrnin pjesë edhe përfaqësues të MPN-së dhe informimit civil.

Çështje e lidhur ngushtë në lidhje me situatën e krizës është edhe kuadrimi i INK-ENK Idrizovë, kështuqë për tejkalimin e këtij problem gjatë vitit 2023 janë shpallur gjithsej 5 konkurse publike për punësim dhe 2 konkurse të brendshme për avancim. Në konkurset e shpallura publike janë punësuar gjithsej 125 persona, nga të cilët 6 persona janë punonjës administrativ, 1 person është staf Teknik-ndihmës dhe 118 persona të mbetur janë police të burgjeve. Së këtejmi, numri i të punësuarve në ENK Idrizovë në fund të vitit 2023 është 289 persona, krahasuar me fillimin e vitit kur ky numër ishte 212 persona. Vlen të përmendet me këtë rast fakti se gjatë vitit 2023 nga institucioni janë larguar gjithsej 57 persona për arsye të ndryshme, vetëm 6 persona janë larguar për arsye të pensionimit¹⁸.

Vetë fakti që kjo situatë krize është prolonguar për një periudhë më të gjatë kohore dhe në përputhje me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është zgjatur deri më datën 30 shtator të vitit 2024¹⁹, tregon qartë sfidat serioze me të cilat po ballafaqohet sistemi penitenciar. Për të tejkaluar më shpejt situatën e krizës, është i nevojshëm një sistem Institucional holistik për mbështetjen e organeve të burgjeve në ENK Idrizovë, si dhe forcimi paralel i kapaciteteve të sistemit penitenciar dhe organeve të burgjeve për t'u përballur në mënyrë të pavarur me situatën aktuale të krizës dhe parandalimin e situatave të ardhshme, të njëjta ose të ngashme të krizave. Kjo imponon nevojën që angazhimet deklarative të shoqërohen me një

¹⁸ Informatë e marrë nga Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, shkresa nr. 06-446/4 nga data 12.03.2024.

¹⁹ Në seancën e mbajtur më datë 28 shkurt të vitit 2024 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi vazhdimin e afatit për ekzistimin e gjendjes së krizës në një pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim për parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë dhe forcimin e sigurisë së INK ENK Idrizovë me të cilin vazhdohet afati i ekzistimit të gjendjes së krizës i përcaktuar në Vendimin për ekzistimin e gjendjes së krizë në një pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta zyrtare e RMV-së“ numër 37/24) deri më datë 30 shtator të vitit 2024

qasje thelbësore, ku sfidat e sistemit kombëtar të burgjeve do të vendosen më lartë në axhendën e prioritetëve të autoriteteve më të larta shtetërore.

Kur është fjala për gjendjen e konstatuar në lidhje me risocializimin, nga inspektimi i bërë gjatë vizitës së dytë në INK-ENK Idrizovë, u konstatua se Sektori për risocializim ka 23 persona (së bashku me kryeshefin dhe ndihmës shefin), gjegjësisht gjysmën e personelit të sistemuar të planifikuar. Vetëm dy prej tyre janë psikologë të cilët në momentin e vizitës së MPN-së mungonin përshkak të sëmundjes. Së këtejmi, 80-90 persona të dënuar janë nën kompetencë të një edukatori, numër i pamundshëm për të menaxhuar, realizuar në mënyrë efektive dhe efikase procesin e risocializimit dhe çfarë do qoftë ndihme në aspekt të korrigjimit të sjelljes, zbulimit të simptomave të hershme të problemeve psikike etj.

Nga viti 2016 e deri në ditën e vizitës, disa persona ishin larguar nga sektori për arsye të pensionimit ose për një vend tjetër të punës, ndërsa për shkak të kushteve të këqija të punës, për të lëshuar vendet e punës shumë shpesh po mendojnë edhe ata të cilët janë akoma në marrëdhënie të punës.

Në entin ndëshkues-korrektues prej vitesh nuk ka angazhim apo trajnim profesiona për të dënuarit siç ka qenë në të kaluarën (zejtari, automekanikë, blegtori, kopshtari etj.), e vetmja gjë që u ofrohet është të ndihmojnë në ruajtjen e higjienës si në vetë objektet ku banojnë, ashtu edhe në rrethin e ENK Idrizovë. Personave të angazhuar në këtë mënyrë u paguhet paga minimale.

Në këtë institucion penitenciar nuk ka as proces arsimor, madje nuk ka as dhoma ku do të zhvillohej i njëjti, po ta kishin. Nuk realizohen kurfarë trajtimeve dhe programe individuale apo grupe.

Sa i përket **repartit të grave të Entin ndëshkues-korrektues (ENK)-Idrizovë**, fokusi kryesor ka qenë vlerësimi i shëndetit mendor të të dënuarave femra, për të cilin janë angazhuar dy bashkëpunëtorë të jashtëm, një psikiatër dhe një psikolog.

Enti ndëshkues-korrektues Idrizovë është institucioni i vetëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut në të cilin ekziston një seksion i veçantë për gratë, ku dënimin me burg e vuajnë gratë e dënuara me aktgjykim të plotfuqishëm për dënim me burgim dhe burgim të përgjeshëm, si dhe fëmijë të gjinisë femërore të dënuara me burgim ose masë edukative, referim në ent edukues-korrektues pavarësisht nga lartësia e dënimit, përkatësisht masës²⁰. Në këtë seksion vuajnë dënimin me burg edhe femrat e huaja dhe femrat pa shtetësi²¹.

Rregullat e OKB-së për trajtimin e të burgosurave dhe masat alternative për gratë kryerëse të veprave penale, të njohura si "Rregullat e Bangkokut"²², parashikojnë vendosjen e të burgosurave femra në institucione që janë afër shtëpive të tyre, duke theksuar përfitimet e strehimit të një gruaje të dënuar pranë vendbanimit të saj, familjes. dhe fëmijëve, duke mos anashkaluar faktin se është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje të kaluarës së gruas së dënuar, përkatësisht

²⁰ Në muajin mars të vitit 2024 u miratuan ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, me të cilat vajzat me masë të shqiptuar edukuese-korrektuese dërgohen në Entin edukues-korrektues Tetovë

²¹ Aktvendim për shpërndarjen e personave të dënuar dhe fëmijëve në institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese, si dhe personave të paraburgosur në seksionet e paraburgimit të institucioneve ndëshkuese-korrektuese (SV-10/2020, nga data 16.01.2020) botuar në Gazetën zyrtare Nr. 10/2020 më datën 16.01.2020.

²² Rregulla nr.4 nga Rregullat e Bangkokut, të arritshme në https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Bangkok_Rules_ENG_22032015.pdf (vizituar më datë 20.11.2023)

nëse ajo ka qenë viktimë e dhunës në familje. Në atë rast, duhet të respektohet dëshira e gruas së dënuar për të mos u vendosur pranë vendbanimit të saj të mëparshëm, sepse kështu do të arrihet distanca fizike nga burri, partneri ose personi që ka kryer dhunë në familje përpara se ajo të dërgohet në vuajtje të dënimit me burg. Në ligjin për ekzekutimin e sanksioneve, ndërkaq, në kushte të caktuara, ndër të tjera, parashihet mundësia që personi i dënuar me kërkesën e tij ose me propozimin e drejtorit të institucionit të zhvendoset nga një institucion në një tjetër të llojit të njëjtë ose të ndryshëm për të qenë më afër vendbanimit ose vendqëndrimit të familjes së tij²³. Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se në raport me gratë, burgu i Idrizovës është i vetmi vend për vuajtje të dënimit me burg apo masës edukative referim në institucionin korrektues, padiskutim rezulton se dispozitat që i referohen zgjedhjes së institucionit penal ose transferimit të të dënuarve nga një institucion në tjetrin janë të pazbatueshme për gratë.

Nëse marrim parasysh arsyet e tjera të parashikuara nga ligji për transferimin e personave të dënuar nga një institucion në tjetrin, rezulton se problemi është shumë më i madh sesa thjesht hapja e çështjes lidhur me parimin e mosdiskriminimit.

Në këtë kuptim, ekipi i MPN-së u interesua nëse për të dënuarat femra ka dispozita, politika apo praktika të veçanta që do të kontribuojnë në trajtimin e barabartë në kushtet kur, për arsye objektive, të dënuarat femra janë në një situatë të pabarabartë, por konstatoi se dispozitat që kanë të bëjnë me vizitat etj. zbatohen në të njëjtën bazë si për të dënuarit meshkuj.

Duke pasur parasysh këtë, ekipi i MPN-së konsideron se është e nevojshme të standardizohen politika dhe praktika të veçanta (p.sh. të lejohen më shumë vizita dhe më të gjata, nëse vizitat janë shumë të rralla, për shkak të distancave të gjata që duhet t'i kalojë familja) që do të kompensojnë këto pakënaqësi praktike me të cilat po ballafaqohen gratë e dënuara dhe do të mirëmbajnë një "de facto" barazi midis të dënuarve meshkuj dhe femra.

Ndërsa, në lidhje me fëmijët, ekipi i MPN-së përsëriti rekomandimin e theksuar në raportet e tij vjetore²⁴ se Ministria e drejtësisë dhe DES është e domosdoshme të marrin masa konkrete me të cilat do të sigurojnë që fëmijët e gjinisë femrore të cilëve me vendim të formës së prerë u është shqiptuar masa edukuese dërgim në ent edukues-korrektues, do të vendosen në institucion të disajnuar në mënyrë speciale për ato dhe nevojat e tyre, në bazë të barabartë me fëmijët e gjinisë mashkullore të cilët janë të vendosur në Ent edukues-korrektues -Tetovë, në fshatin Vollkovi²⁵.

Sa i përket **kushteve materiale** është konstatuar se janë marrë masa dhe aktivitete të caktuara për përmirësimin e tyre, dysheme të re, dritare të ndërruara, si dhe dollapë me çelës për çdo të dënuar në korridorin e repartit të mbyllur. Megjithatë gjatë vizitës u konstatua se në shumicën e dhomave, për shkak të mungesës së hapësirës ku do të ruanin sendet e tyre personale, femrat e dënuara detyrohen t'i ruajnë ato nën krevetet e tyre, gjë që lë përshtypjen e mbipopullimit në shumicën e dhomave.

²³ Nen. 223 nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve („Gazeta zyrtare e RMV-së” nr. 99/19, 220/19 dhe 236/22)

²⁴ Shiko Raportin vjetor të MPN-së për vitin 2021, në dispozicion në: <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/NPM-dokumenti/2021/NPM%20Godisen%20izvestaj-2021.pdf>, vizituar për here të fundit më datën 20.11.2023.)

²⁵ Ky rekomandim është miratuar në ndërkohë në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e miratuara të reja të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve.

Në shumicën e dhomave u konstatua se ka një përqindje të lartë lagështie dhe qasja e të dënuarave femra në tualetin dhe banjot në ambientet e mbyllura është një shqetësim serioz, sepse të gjithë të dënuarit janë të detyruar të ndajnë aksesin në to. Në këtë kuptim u pranuan pretendimet se disa të dënuara pothuajse gjithmonë detyrohen të bëjnë dush në mbrëmje pas mesnate (në orën 3-4 të mëngjesit), përkatësisht derisa të tjerët flejnë për të shmangur "tensionin e panevojshëm". Tualeti dhe banjot nuk janë të përshtatura për të dënuarit që kanë një lloj paafësie fizike ose për ato që për shkak të gjendjeve të tjera kanë nevojë për ndihmë nga personi i tretë. **Prandaj, është e nevojshme të merren masa të menjëhershme për rregullimin e tualetit dhe banjove jo funksionale dhe përshtatjen e tyre për përdorim nga të dënuarat femra me aftësi të kufizuara fizike.**

Frika dhe pasiguria janë veçanërisht të theksuara tek ato të dënuara që janë këtu për here të parë. Gjegjësisht, të dënuarat femra të sapo pranua akomodohen në një dhomë të vendosur në repartin e mbyllur të grave. Fakti që të burgosurat e sapopranuara vendosen menjëherë në repartin e mbyllur dhe vijnë në kontakt dhe ndikim të drejtpërdrejtë me të burgosurat e tjera që janë me trajtim të mbyllur mund të ketë një ndikim negativ dhe të intensifikojë privimet fillestare të burgut, si për shembull, privimi i sigurisë (shoqërimi i detyrueshëm me të burgosurat e tjera të paparashikueshme, që shkakton frikë dhe ankth sepse duhet të luftojnë për sigurinë e personalitetit të tyre, por edhe për sendet e tyre personale).

Në këtë kuptim, dhe duke pasur parasysh se trajtimi i personit të dënuar në repartin e pranimi duhet të përfaqësojë një sërë aktivitetesh dhe masash për trajtimin e personit të dënuar për t'u njohur me rregullat e vuajtjes së dënimit me burg (Rregullorja për Rendin e shtëpisë për personat e dënuar që vuajnë dënimin me burg në institucion ndëshkues-korrektues), vlerësimi i personalitetit të tij, vlerësimi i rrezikut, përpilimi i planit të dënimit dhe përcaktimi i trajtimit të personit të dënuar gjatë vuajtjes së dënimit me burg, **ekipi i MPN-së rekomandon që pranimi i të dënuarave të reja femra të bëhet në një pjesë tjetër të seksionit të grave, të ndarë nga reparti i mbyllur.**

Nga këqyrja e kryer në evidencën e **sanksioneve disiplinore**, u konstatua se nga fillimi i vitit deri në ditën e vizitës janë realizuar 13 procedura disiplinore, prej të cilave në 5 raste është shqiptuar dënimi disiplinor – dërgim në izolim për 5 ditë dhe kjo për arratisje, konfrontim fizik apo për shkak të celularit. Gjatë periudhës kur të dënuarat femra mbahen në izolim (dhomë 1,95 m e gjatë, 3,6 m e gjerë dhe 3,9 m e lartë) kanë të drejtën e një ore shëtitjeje, ndërsa pjesën tjetër të kohës e kalojnë në izolim, ku i marrin edhe shujtat. Qelitë janë të pajisura me nje sanitare të ndarë, një lavaman dhe shtretër të vjetër metalikë, me dyshekë të grisur dhe çarçafë të ndotur. Në dhomat e izolimit ishin të dukshme edhe gjurmë nga myku, ndërsa në njërin prej tyre kishte edhe një kablo elektrik të varur që do të mund të përdoreshte edhe për vetëlëndim të mundshëm

Duke marrë parasysh efektet e mundshme të dëmshme të masës-izolim për gratë e dënuara ndaj të cilave shqiptohet e njëjta, ekipi i MPN-së mendon se kjo masë duhet të përdoret si denim disiplinor vetëm në raste të jashtëzakonshme, si mjet i fundit dhe në periudhë më të shkurtër të mundshme.

Nga këqyrja e kryer në Librin që mbahet për **mjetet e përdorura të shtrëngimit**, u konstatua se nuk ka pasur raste të regjistruara të përdorimit të mjeteve shtrënguese në dy vitet e fundit. Përveç në raste të caktuara gjatë kryerjes së transferimit ku përdoren mjete për lidhje pas një vlerësimi paraprak (i cili shënohet në urdhrin për transferim), nuk ka pasur pretendime të tjera dhe nuk ka pasur të dhëna se janë përdorur mjete shtrëngimi ndaj të dënuarave femra.

Dispozitat e ligjeve që rregullojnë trajtimin ndaj personave të dënuar nuk parashikojnë bas-

tisje intrusive që përfshijnë kavitetet e trupit, përveç inspektimit vizuel të pjesëve intime. Ligji për procedurën penale parashikon se për kontrollin e pjesëve intime të trupit apo të kavitateve të trupit është i nevojshëm miratimi i shqiptuar i gjykatës dhe se kontrollet intime kryhen nga një person mjekësor²⁶.

Korniza normative aktuale nuk parasheh dhe nuk lejon një zëvendësim të plotë të bastisjes nëpërmjet aplikimit të metodave të reja, më moderne, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve për skanim të trupit. Në praktikë, pajisjet përdoren për skanimin e dërgesave, d.m.th çantave dhe mjeteve të tjera, si dhe detektorë metali në formën e portave dhe detektorëve për celularë.

Nga bisedat e zhvilluara gjatë vizitës, është marrë informacion se gjatë hyrjes në objekt ose gjatë kthimit nga dalja e mëparshme, personat e dënuar fillimisht kalojnë përmes detektorit të metaleve dhe kontrollit që përfshin verifikime/kontroll të jashtëm të veshjes. Nëse detektori i metaleve sinjalizon praninë e mundshme të ndonjë sendi metalik ose pjesëtarët e policisë së burgjeve dyshojnë se i dënuari ka mundësi të fshehtë ndonjë send të palejueshëm, atëherë bëhet kontrolli që përfshin heqjen e rrobave, në atë mënyrë që personi të mos i heqë të gjitha rrobat përnjëherë, por fillimisht nga gjysma lart, pastaj pas veshjes i heq rrobat nga gjysma poshtë. Kjo bëhet në një vend/kabinë të veçantë, ku të dënuarit nuk janë të ekspozuar ndaj shikimit të personave të tretë. Të dënuarat femra me të cilat është biseduar theksuan qëndrimin korrekt të policisë së burgjeve gjatë kontrolleve.

Ekipi i MPN-së mori informacione se përjashtime të rastësishme të praktikës së heqjes së të gjitha veshjeve në të njëjtën kohë janë bërë nga pjesëtarët e policisë të cilët kanë qenë në detyrë gjatë periudhës së krizës së shpallur në objekt, në këtë kuptim është marrë informacion se ka pasur raste kur kontrollet janë bërë në kabina të veçanta, por njëkohësisht burrat janë zhveshur tërësisht.

Në këtë kuptim, ekipi i MPN-së i referohet nevojës që të gjithë personat e angazhuar në mënyrë plotësuese për shkak të situatës së deklaruar të krizës, të cilët janë të autorizuar për të kryer kontrolle në institucion, fillimisht të njihen plotësisht me rregullat për mënyrën e kryerjes së kontrollit personal nga ana e Policisë së burgut.

Nga biseda me shumicën e të dënuarve, theksohet se aspekti më i vështirë i qëndrimit në burg është ndarja nga fëmijët, respektivisht ndarja fizike dhe psikologjike nga fëmija/fëmijët, gjë që i pengon ata të kujdesen për të/ata dhe që ndikon keq në shëndetin e tyre mendor.

Shumica e grave theksojnë se për të parë fëmijët e tyre shfrytëzojnë maksimumin e 2 orëve në muaj (nga një orë në dy javë). Të pamurit bëhen në dhomën e përbashkët të vizitave, ndërsa në këtë burg nuk ka ende dhomë apo kënd të veçantë për t'u parë me fëmijët. Tek gratë, fëmijët e të cilave për arsye të ndryshme janë të vendosur në familje kujdestare, situata është edhe më e ndërlikuar, pasi vizitat organizohen nga qendra për punë sociale e qytetit nga është femra, me kërkesë të nënës. Sipas të dënuarave, takimet e tilla janë jashtëzakonisht të rralla, ndonjëherë nuk ndodhin fare.

Prandaj, **nevojitet një iniciativë dhe bashkëpunim më të madh ndërmjet shërbimit social të burgut dhe qendrave për punë sociale. Gjithashtu, nevojiten kontakte më cilësore me fëmijët e tyre (më të shpeshta, më të gjata dhe në kushte të përshtatshme për fëmijët, dhoma).**

²⁶ Neni 185 nga Ligji për procedurën penale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18)

Sa i përket **angazhimit në punë**, ekipi i MPN-së konstaton se i njëjti reduktohet vetëm në ruajtjen e higjienës në ambiente, që është e pamjaftueshme. Angazhimi në punë përmes punës intelektuale është diçka që e dëshirojnë, veçanërisht femrat e arsimuara. Mungesa e angazhimit në punë i pasivizon femrat dhe i çon drejt nevojës më të madhe për medikamente për qetësim, kështu që disa prej tyre e kalojnë pjesën më të madhe të kohës në gjumë.

Sa i përket **edukimit dhe trajnimeve** për zanate të caktuara, ato organizohen herë pas here, por fatkeqësisht pa vazhdimësi dhe konsistencë. Më parë për trajnime të tilla janë dhënë certifikata, të cilat kanë paraqitur kënaqësi shtesë nga puna e bërë dhe mundësi për shanse të reja në të ardhmen, pas daljes nga burgu. Fatkeqësisht, trajnime të tilla nuk janë pjesë e sistemit, kështu që ato zhvillohen vetëm nëse parashikohen me ndonjë projekt. Sapo përfundon projekti, përfundojnë edhe trajnimet.

Do të ishte mirë që të organizoheshin trajnime të përhershme për zanate që do t'u siguronin të dënuarave femra një strukturim të dobishëm të kohës së tyre në burg dhe përshtatje më të lehtë në periudhën pas dënimit. Duke pasur parasysh zhvillimin e përsheptuar të teknologjisë dhe shërbimeve digjitale, duhet të mendohet për futjen e trajnimeve që do të forcojnë aftësitë digjitale të të dënuarave femra. Kjo do të kishte një efekt pozitiv për shëndetin e tyre mendor: rritjen e vetëbesimit, ndjenjën e përmbushjes, uljen e ankthit për jetën pas daljes nga burgu.

Ky seksion nuk disponon me hapësirë të specializuar për aktivitete dhe ngjarje kulturore dhe sportive (p.sh. palestër), kështu që gratë kanë vetëm dy orë në ditë për të ecur jashtë, përreth seksionit. Gratë në dhomat e tyre kanë televizorë dhe kjo është jeta e tyre e vetme kulturore dhe argëtuese. Nëse merret parasysh mjedisi i përgjithshëm me kushtet johigjienike në ambientet e burgut, cilësia e dobët e ushqimit, mbipopullimi në dhomat e burgut, objektet e rrënuara, e gjithë kjo kontribuon për përkeqësimin e shëndetit somatik dhe mendor të të dënuarave femra.

Privimi nga liria, veçanërisht privimi për shumë vite, ka ndikim destruktiv në mirëqenien psikologjike, fizike dhe sociale të këtyre personave. Pikërisht për këtë arsye **mbështetja psikologjike dhe psikoterapia** janë të nevojshme për përballimin dhe përshtatjen e suksesshme në jetën e burgut. Pranimi i regjimit të burgut dhe ndërtimi i rutinave, që ndikon në rritjen e vetëbesimit, ndjenjës së kontrollit mbi jetën e vetë, sigurisë, uljes së stresit, ju mundëson që jeta e tyre e përditshme të ketë kuptim.

Në seksionin e femrave në INK – ENK Idrizovë nuk ka psikolog, e vetmja psikologe është në Seksionin e pranimit, e cila ka munguar gjatë vizitës, gjegjësisht në pushim mjekësor afatgjatë (zëvendësimi në mungesë nuk është gjetur) për këtë arsye të dënuarat e sapo të arritura nuk kishin raport dhe mendim psikologjik, i cili është dokument i detyrueshëm mbi të cilin përcaktohet trajtimi i mëtejshëm²⁷. Nga këqyrja e dokumentacionit mungojnë edhe testet e aplikuara, teknikat dhe peshoret e nevojshme për psiko-diagnostikimin e të dënuarave të rinj. Prandaj, **rekomandohet që institucioni të marrë instrumentet e patjetërsueshme psikologjike dhe menjëherë të pranojë psikolog në seksionin e pranimit.**

Në pjesën e burgut për femra nuk praktikohen as trajtime grupore edhe pse para disa vitesh është zbatuar një program pilot për një program të përgjithshëm njohës, si dhe për programe specifike që zbatohen në grup, mes tyre edhe programi për të dënuarat femra.

Puna e grupeve për trajtim me ushtrime për çlirim nga tensioni, rritjen e vetëbesimit, nxitjen e strategjive që synojnë emocionet, humorin dhe riinterpretimin pozitiv, zgjidhjen e konflikteve, rritjen e inteligjencës emocionale, përmirësimin dhe

²⁷ Në institucion është edhe një psikolog për arsimim i cili punon si edukator.

forcimin e marrëdhënieve me të dënuarit e tjerë duke përmirësuar aftësitë e komunikimit, fillimisht do të ndikonte për përmirësimin e shëndetit mendor. Mungesa e këtij lloj programi nuk kontribuon në ruajtjen e shëndetit mendor të të dënuarave femra.

INK - ENK Idrizovë ka një mjek - psikiatër i cili vjen një herë në javë, ndërsa në të njëjtën kohë është e angazhuar edhe në INK burgun Shkup dhe është në marrëdhënie të rregullt të punës në Spitalin psikiatrik "Shkup". Duke pasur parasysh obligimet e shumta të një psikiatri, i cili në të njëjtën kohë është i angazhuar në tre institucione, si dhe vëllimin, përkatësisht numrin e personave që kanë nevojë për kujdes, trajtim dhe vëzhgim psikiatrik, veçanërisht kur dihet se tek të dënuarit rreziku nga paraqitja e problemeve psikiatrike/mendore është i theksuar në periudhën fillestare pas privimit nga liria, atëherë padyshim që mund të përfundohet se ky person nuk mund t'u përgjigjet në mënyrë të përshtatshme dhe të duhur nevojave të tre institucioneve dhe për këtë arsye nevojitet që çdo institucion ndëshkues - përmirësues të ketë të punësuar psikiatër, si dhe infermiere të trajnuar për punë në këso lloj institucioneve.

Paraqitja e çrregullimeve mendore tek të dënuarat është e zakonshme për institucione të tilla, pra tek të dënuarat më së shpeshti diagnostikohet çrregullimi i personalitetit, çrregullime neurotike, si dhe sëmundje të varshmërisë nga substancat psikoaktive.

Terapia medikamentoze që jepet është në përputhje me standardet dhe tendencat e tanishme në dispozicion të popullatës së përgjithshme të komunitetit, megjithatë hapësira ku ruhen ilaçet, si dhe mënyra e realizimit të së njëjtës janë të papërshtatshme. Njëherit, programet parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor dhe programet parandaluese për kujdesin shëndetësor nga mjekësia e përgjithshme duhet të jenë në fushën e shërbimit shëndetësor të burgjeve.

Sipas të dhënave të marra nga shërbimi shëndetësor i burgut, të varurve u është dhënë mundësia të zgjedhin në lidhje me terapinë zëvendësuese për varshmërinë nga opiumet, e cili realizohet në Qendrën për program metadoni në të cilin janë përfshirë 200 të dënuar me metadon dhe 14 të dënuar me bunrenorfin, përkatësisht 10 të dënuara janë me metadon dhe 1 e dënuar është me buprenorfinë, megjithatë edhe mëtutje mbetet përfundimi se nuk ka të punësuar ekip të posaçëm (psikiatër, psikolog, punëtor social, etj.) që të merret me atë çështje. Metadoni është më i lirë dhe është në listën pozitive të Fondit për sigurim shëndetësor (FSSH), ndërsa buprenorfina është më e shtrenjtë dhe nuk është në atë listë. Sidoqoftë, duhet të theksohet se për të dy barërat ekzistojnë rregulla dhe indikacione të rrepta për përdorim. Psikiatri përcakton se cila terapi dhe në çfarë doza do të praktikohen sipas indikacioneve dhe me kontratë terapeutike me pacientin – të varurin. Qasja dhe përzgjedhja e terapisë së zëvendësimit është e mundur, por për çdo terapi zëvendësimi i varuri duhet të përmbushë disa kritere, përkatësisht një ekip multiprofesional vlerëson dhe monitoron më tej dhe adapton trajtimin e të varurit.

Kujdesi shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore për femrat e dënuara në kushtet e burgut duhet të jenë në nivel adekuat, të vazhdueshëm dhe në kohë. Shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në mënyrë që t'u përgjigjet kërkesave për konsultë mjekësore ose ekzaminim mjekësor pa vonesë dhe duke respektuar privatësinë e të dënuarave femra. Duke pasur parasysh se burgjet nuk mund të plotësojnë të gjitha nevojat e mundshme të të dënuarve në fushën e kujdesit shëndetësor, veçanërisht nevojën për ekzaminime specialiste, duhet pasur kujdes që ato të sigurohen në koordinim me institucionet përkatëse.

REKOMANDIME KYÇE:

- Të angazhohen më shumë bashkëpunëtorë profesional (psikolog, punonjës social, terapist profesional, infermiere e trajnuar për të punuar në psikiatri, edukatore e arsimuar);
- Qasje tek shërbimet dentare për të gjithë të dënuarit në vazhdimësi, jo vetëm në raste më urgjente;
- Të krijohet një protokoll zyrtar për fiksime dhe edukim për punë me femrat e dënuara me çrregullime mendore;
- Të përgatitet një program për trajtim individual dhe grupor për risocializim me plan për përfshirjen e personave të dënuar në komunitet pas daljes nga burgu;
- Të mundësohet që të angazhohen në punë të gjitha gratë, si dhe të edukohen dhe trajnohen për zanate, por edhe të ju mundësohet të dënuarave femra që të kenë qasje në sport dhe lloje të tjera të aktiviteteve rekreative;
- Të rritet niveli i higjienës dhe të rinovohen ambientet sanitare.

3.2 INSTITUCIONI NDËSHKUES – KORREKTUES BURGU SHKUP

Seksioni i paraburgimit në Institucionin ndëshkues – korrektues Burgu Shkup ka gjithsej 286 shtretër, ndërsa kapaciteti i seksionit në bazë të kriterit (min 9m³/4m² për person) është për 243 të paraburgosur. Në ditën e vizitës në këtë seksion ndodheshin gjithsej 261 të paraburgosur, nga të cilët 15 gra (të vendosura në 4 dhoma) dhe 1 fëmijë i vendosur veçmas në Korridorin V.

Pjesa e paraburgimit të burgut është e ndarë në korridoret A, B, C, G dhe D. Numri i të paraburgosurve tejkalon kapacitetin akomodues të institucionit, gjë që mund të shihej gjatë inspektimit të ambienteve.

Sa i përket numrit të policisë së burgjeve, i njëjti shënon një trend të rënies së vazhdueshme edhe pse në vitin 2023 u punësuan 15 punonjës të burgjeve.

Një nga sfidat me të cilat ballafaqohen institucionet ndëshkuese përmirësuese, e cila ndikon në motivimin e të punësuarëve dhe indirekt në qëndrimin ndaj personave të paraburgosur/të dënuar, është sistemi i (pa) krijuar i avancimit në karrierën profesionale. **Në këtë kuptim, theksohet se të punësuarit demotivohen nga rastet kur në vend të avancimit të personelit i cili tashmë ka përvojë dhe njohuri në punë, në institucion punësohen persona nga jashtë që nuk kanë përvojë të mëparshme me sistemin penitenciar edhe ate në pozita më të larta.** Tek një pjesë e të punësuarëve mund të vërehet se ka një shkallë të lartë të zhgënjimit, apatisë dhe demotivimit.

Sfidë janë edhe kushtet e punës, ndaj edhe disa nga të punësuarit edhe në këtë institucion penitenciar janë ankuar për mungesë të uniformave²⁸, pajisjeve të punës – prangave, por edhe

²⁸ Prej 8 vitesh nuk kanë marrë uniforma

radio-lidhjeve.

Burgu nuk ka as automjete të mjaftueshme për përcjellje, kështu që për këtë janë në dispozicion 4 vetura, dy prej të cilave janë huazuar nga INK Shtip dhe INK Prilep.

Ndër temat për të cilat u diskutua gjatë vizitës ishte edhe çështja e rasteve të mundshme të korrupsionit në Institucion. Pra, u tha se në 10 deri në 15 vitet e fundit nuk kryhen kontrolle shtesë për personalitetin dhe profilin e kandidatëve për praninë në institucion, por vetëm se kërkohet së kandidati duhet të dorëzojë dëshmi se nuk ka aftësi të kufizuar të veprimtimit. Pikërisht kjo është arsyeja e rritjes së zërave për ekzistimin e korrupsionit në institucione të tilla, ndërsa nga ana tjetër rënies së integritetit dhe parimeve etike tek të punësuarit.

Nuk ka ekipe për vlerësimin e rrezikut të vetëvrasjes së personave të paraburgosur, ndërsa në proces është përpunimi i Rregullores për vëzhgim me video.

Duke marrë parasysh të lartëpërmendurën, ekipi i MPN-së konsideron se është i nevojshëm rishikimi i kushteve për punësim të sigurimit të burgjeve, si dhe dërgimi i personelit në trajnime më të gjata hyrëse për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e personave të sapopunësuar, por edhe kontrollë të vazhdueshme të kredibilitetit të tyre moral dhe të besueshmërisë para se të hyjnë në shërbim.

Nga bisedat e bëra me personat e paraburgosur në INK Burgu Shkup, ekipi i MPN-së ka konstatuar se me rastin e **pranimit të personave tani të paraburgosur**, disa prej personave kontrollohen në atë mënyrë që zhvishen lakuriq, praktikë kjo që është në kundërshtim me standardet e kontrollit - sidomos kur bëhet fjalë për femrat²⁹. **BPraktika e tillë lirisht mund të klasifikohet si trajtim nënçmues, përkatësisht poshtërues, duke marrë parasysh shqetësimin, turpin dhe ndjenjën e pafuqisë që u shkaktohet personave që kontrollohen.** Standardet³⁰ parashikojnë heqjen e pjesshme të rrobave, përkatësisht pasi të kontrollohet pjesa e sipërme e trupit dhe të vishen rrobat, të kalohet në pjesën e poshtme të trupit. Çdo kontroll, përkatësisht ekzaminim i pjesëve intime, respektivisht kavitacioneve, duhet të bëhet nga një person profesionist (mjekësor).

Ekipi i MPN-së në mënyrë plotësuese vëren se gjatë kontrollit është i pranishëm vetëm një person, në vend se të jenë dy, siç e parashikon neni 9 i Rregullores së shtëpisë për ekzekutimin e masës së paraburgimit³¹.

Në lidhje me ekzaminimin mjekësor gjatë pranimit, ekipi i MPN-së nuk ka vërejtje, ai kryhet brenda 24 orëve nga pranimi i personit në institucion dhe kryhet sipas protokolleve të parapara.

Megjithatë, ekipi i MPN-së konstatoi se gjatë pranimit personat nuk njoftohen me rendin shtëpiak të paraburgut nga zyrtarët e burgut, por këtë informacion e marrin nga personat me të cilët janë akomoduar në dhomë/qeli.

Nga këqyrja e bërë në seksionin e paraburgimit të INP Burgut Shkup, por edhe nga bisedat e zhvilluara me të paraburgosurit, lirisht mund të konstatohet **se kushtet materiale në këtë institucion ndëshkues - përmirësues janë nën çdo nivel dhe standard.**

²⁹ European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT), Women in Prison, Factsheet, January 2018 <https://rm.coe.int/168077ff14> (Qasur me datë: 28.02.2024)

³⁰ Ibid

³¹ Rregullore për rendin e shtëpisë për ekzekutimin e masës së paraburgimit në seksionet e paraburgimit në burgje („Gazeta zyrtare e RMV“, nr.87/2020 e datës 02.04.2020)

Dhomat të cilat ekipi i MPN-së i inspektoi janë plot me myk, lagështi dhe në disa dhoma dhe mure të tëra ishin të zeza nga myku. Ajri në dhoma është i ndenjur për shkak të ajrosjes së dobët, dhe ka mungesë të dritës natyrale, por edhe asaj artificiale (dhomat zakonisht ndriçoheshin nga një llambë).

Dyshekët mbi të cilët flinin të paraburgosurit ishin të vjetër dhe të konsumuar, ndërsa batanijet dhe shtroja ishin të pista. Dhomat zakonisht ishin të pajisura me një tualet, diku të ndara nga shtretërit me një mur pa derë, në të cilin ka një çeshme (me ujë të ftohtë) dhe njësi sanitare ("çuçavec").

Ngrohja në ambiente është qëndrore, por të paraburgosurit ankohen se nuk ngrohen mjaftueshëm, pra ndizet vetëm disa orë gjatë ditës ose ngrohet natën kur të gjithë flenë.

Ambientet ishin të pista dhe të paraburgosurit u ankuan për mungesën e mjeteve për mbajtjen e higjienës në to, si dhe mjeteve (detergjentëve, pluhurave) për të ruajtur higjienën e rrobave të tyre (gjatë vizitës ekipi i MPN-së gjeti një të paraburgosur duke larë rrobat e veta me sapun të zakonshëm të duarve). Rrobat thahen në të njëjtën dhomë, mbi radiator ose pranë dritares së vetme.

Kur bëhet fjalë për mjetet e ruajtjes së higjienës personale, na u tha se u jepet sapun, pastë dhe furçë dhëmbësh, ndonjëherë edhe shampun "bikçe", por ndodhë që të njëjtit të jenë me afat të skaduar.

Kushteve të këqija në të cilat qëndrojnë të paraburgosurit ju kontribuojnë edhe çerdhet e insekteve - taftabitat, kështu që në njërin prej dhomave të vizituara, në të cilën qëndronin pesë persona, të gjithë ishin të pickuar nga këto insekte (fjalë për fjalë kishin pickime në të gjithë trupin: krahë, këmbë, shpinë).

Për kushtet e këqija, ndërsa para së gjithash higjienën e të paraburgosurve, veçanërisht të të paraburgosurve femra, nevojat specifike të të cilave madje janë të cekura në nenin 19 të Rregullores për rendin e shtëpisë për ekzekutimin e masës së paraburgimit³², Për kushtet e këqija, ndërsa para së gjithash higjienën e të paraburgosurve, veçanërisht të të paraburgosurve femra, nevojat specifike të të cilave madje janë të cekura në nenin 19 të Rregullores për rendin e shtëpisë për ekzekutimin e masës së paraburgimit

Kushtet e tilla janë krejtësisht në kundërshtim me standardet e brendshme dhe ndërkom-bëtare³³ për akomodimin e personave të dënuar me paraburgim, veçanërisht nëse e kemi parasysh se masa e tillë duhet të shqiptohet si masë e fundit dhe vetëm atëherë kur është absolutisht e patjetërsueshme³⁴.

Si rrethanë tjetër rënduese është dhuna apo arbitrariteti i pranishëm i disa të paraburgosurve ndaj shokëve të dhomës, për shkak të së cilës ata që vuajnë presion jetojnë në frikë të vazhdueshme dhe shpeshherë janë të ekspozuar ndaj sulmeve fizike dhe psikologjike.

Kështu, duke pasur parasysh faktin se vetë qëndrimi në paraburgim mund të shkaktojë probleme serioze psiqike (shkalla e vetëvrasjeve tek të paraburgosurit është më e lartë se ajo

³² Rregullore për Rendin e shtëpisë për ekzekutimin e masës së paraburgimit në seksionet e paraburgimit në burgje („Gazeta zyrtare e RMV-së“, nr.87/2020 e datës 02.04.2020)

³³ European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT), Women in Prison, Factsheet, January 2018

³⁴ European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT), Remand detention, Extract from the 26th General Report of the CPT, published in 2017

e të dënuarve), por edhe vështirësi të tjera shëndetësore, kushtet e këtyra të qëndrimit, si dhe rreziku i dhunës ndërmjet personave të vendosur në një dhomë, gjithashtu përbën rrezik për shëndetin dhe sigurinë e të paraburgosurit.

Në bazë të gjendjes së konstatuar gjatë vizitës, ekipi i MPN-së thekson se është e nevojshme të merren masa urgjente për përmirësimin e kushteve materiale të të paraburgosurve, veçanërisht për t'iu kushtuar vëmendje nevojave të veçanta të të paraburgosurve, si dhe për të bërë vlerësime të mira të rrezikut për të parandaluar dhunën ndërmjet personave të vendosur në të njëjtën dhomë.

Ekipi i MPN-së vizitoi edhe fëmijën e vetëm të akomoduar në këtë institucion me masë të shqiptuar të paraburgimit. Gjatë vizitës, fëmija ishte në paraburgim prej dy muajsh, në kushte aspak të pranueshme për një fëmijë nën 18 vjet, i lënë vetëm mes katër mureve, pa asnjë aktivitet dhe me nivel shumë të ulët të higjienës. Në një kënd të dhomës ku ishte vendosur, kishte mbeturina të grumbulluara, çarçafët dhe batanijet ishin të pista, ajri ishte i ndenjur dhe i vështirë, ndërsa ndriçimi artificial dhe i pamjaftueshëm. Përveç kontakteve me sigurimin e burgut, fëmija nuk ka pasur ndonjë aktivitet të qëllimshëm apo kontakte me shërbimet profesionale. Përfundim i përgjithshëm është se **kushtet e tilla janë jashtëzakonisht të pranueshme dhe në kundërshtim me të gjitha standardet, thelbi i të cilave është interesi më i mirë i fëmijës**³⁵.

Kujdesi shëndetësor për personat e paraburgosur dhe të dënuar në Burgun e Shkupit ofrohet nga ekipi mjekësor i përbërë nga një mjek (psikiatër në pension), i cili është i angazhuar me kontratë dhe i cili ishte i pranishëm në ditën e vizitës, pastaj një mjek tjetër, i cili ndodhet në specializim, si dhe dy motra medicinale, një teknik mjekësor, si dhe një motër medicinale e stomatologjisë. Një herë në javë, Burgun e viziton psikiatër. Nga informacionet e marra, Burgu ka mbështetje mjekësore 24 orëshe për të paraburgosurit përmes kujdestarive të organizuara.

Gjatë vizitës u konstatua se ambulanca i ka të gjitha barnat e domosdoshme që janë në listën pozitive, ndërsa pas një raporti të mëparshëm mjekësor, personat mund të marrin edhe barnat e sjella nga familjet e tyre. Barnat shpërndahen nga rojet sipas urdhrit të mjekut, ndërsa rishpërndarja e barnave/terapisë bëhet nga motra medicinale. Analizat hematologjike dhe laboratorike kryhen nga institucionet shëndetësore, ndërsa mostrat merren vetëm në ambulancë. Gjatë vitit 2023 janë lëshuar mbi 2000 udhëzime për ekzaminime specialiste.

Procedurat që ndiqen gjatë pranimit të ndonjë personi të ri të paraburgosur përfshijnë ekzaminim sistematik nga personeli mjekësor, me ç'rast merret anamneza, hapet kartela shëndetësore ku regjistrohen sëmundjet e mëparshme, terapia për sëmundjet kronike, ndërhyrjet e mëparshme kirurgjikale, gjatësia dhe pesha e të paraburgosurit, barnat për sëmundjet kronike dhe gjendja mendore. Në lidhje me personat e paraburgosur, u tha se shumica e tyre janë në gjendje specifike psikike e cila është shumë komplekse dhe për këtë një numër të madh të tyre u përshkruhen qetësues.

Edhe pse ekipi i MPN-së nuk ka hasur në asnjë ankesë, megjithatë ka pasur vërejtje individuale se rezultatet e ekzaminimeve nga shëndetësia sekondare nuk

³⁵ United Nations Rules for the Protection of Juveniles Deprived of their Liberty, Adopted by General Assembly resolution 45/113 of 14 December 1990 Достапно на: https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/United_Nations_Rules_for_the_Protection_of_Juveniles_Deprived_of_their_Liberty.pdf (Qasur me datë: 15.12.2023)

janë marrë në kohë të duhur, barnat që u përshkruhen personave të privuar nga liria nuk ndryshohen gjithmonë në kohën e duhur, ndërkaq dhe nuk ju ofrohet ndihmë në kohe pasi pickohen nga tavtabitët.

Ndonëse sigurimi i burgut na informoi se kryhen xhiro të rregullta (sidomos gjatë natës) dhe rregullisht ofrohet ndihmë nëse ka nevojë për ndihmë urgjente (duke pasur parasysh që brenda hapësirave butonat e urgjencës nuk funksionojnë), megjithatë nga të paraburgosurit u krijua përshtypje që madje dhe kur kanë nevojë presin gjatë që dikush nga shërbimet të vijë dhe t'u ofrohet ndihmë.

Gjatë vizitës është bërë këqyrje në evidencën që administrohet për **përdorimin e forcës dhe mjeteve detyruese** ndaj personave të paraburgosur, me ç'rast janë evidentuar gjithsej 11 raste lidhur me përdorimin e forcës apo mjeteve për detyrim, prej të cilave 4 raste kanë të bëjnë me përdorimin e prangave për këmbë dhe duar dhe mjete të lidhjes, ndërsa në të tjerat raste bëhet fjalë për masë të shqiptuar për mbikëqyrje të shtuar në dhomë, nën mbikëqyrje video dhe kontroll të rreptë të terapisë. Gjegjësisht, ekipi i MPN-së mirëpret faktin që fiksimi fizik nuk përdoret më për më shumë se një vit. Kohëzgjatja e izolimit dhe e referimit në dhomë nën mbikëqyrje video dhe nën kontroll të rreptë të terapisë shënohet në një fletore, ku shënohet se në raste të caktuara izolimi ka zgjatur më shumë se 15 ditë. Duke pasur parasysh këtë, **ekipi i MPN-së thekson se është e nevojshme që gjatë referimit të personave në izolim të merren parasysh efektet negative të një ndarjeje të tillë, e cila duhet të pasohet nga një rishikim më i shpeshtë i nevojës për vazhdimin e masës edhe atë drejtëpërdrejtë nga një profesionist mjekësor.**

Përdorimi i mjeteve për lidhje gjatë përcjelljes theksohet në urdhrin për përcjellje, ndërsa në bazë të vlerësimit paraprak të rrezikut dhe për këtë arsye për përdorimin e tillë të mjeteve për lidhje nuk hartohen protokolle, standarde të funksionimit. Në këtë kuptim, **ekipi i MPN-së rekomandon që të merren parasysh dispozitat që e rregullojnë përdorimin e mjeteve për lidhje gjatë përcjelljes, veçanërisht ato që parashohin se: „Personi që përcillet nuk duhet t'i lidhen duart pas shpine, për shkak të rrezikut të lëndimit në rast aksident trafiku.”, si dhe se „Personi i privuar nga liria gjatë përcjelljes nuk duhet të jetë i lidhur për gardhi, pajisje apo sende të tjera.”** Përgjegjësi e personelit të lartë të policisë së burgjeve është të sigurojë që dispozitat që parashikojnë përdorimin e forcës dhe mjeteve të detyrimit, madje edhe në rastet e përcjelljes të zbatohen ashtu siç duhet në rastet e shoqërimit³⁶.

Edhe pse Rregullorja për Rendin shtëpiak për ekzekutimin e masës së paraburgimit, në një pjesë të posaçme i parashihet të gjitha kushtet humane për qëndrimin e personit në paraburgim, nga konstatimet e cekura më lartë, mund të konstatohet se **higjiena** në seksionin e paraburgimit të INK Burgu Shkup është nën standardet minimale të kushteve për mbajtjen e higjienës personale dhe higjiena e dhomës ku qëndrojnë të paraburgosurit është në nivel shumë të ulët, ndërsa shtrati dhe sendet personale/veshjet e personave të privuar nga liria dhe të paraburgosurve është e papastër dhe nuk ka mundësi që ku të lahet/thahet.

Sa i përket **ushqimit**, disa të paraburgosur u ankuan se i njëjti është pa shije, i njëjtë dhe

³⁶ Rregullore e detajuar për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve për detyrim nga ana e pjesëtarëve të policisë së burgjeve në institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe institucionet edukuese – korrektuese. Numër i (“Gazeta zyrtare” nr.94/22 e datës 15.04.2022)

krejtësisht i papranueshëm. Atyre nuk ju jepen fruta dhe perime, si dhe produkte të qumështit (qumësht, kos, etj.). Ata nuk kanë mundësi të gatujnë, ndaj janë plotësisht të varur nga ushqimi që u dërgojnë familjarët apo mensa lokale, ku çmimet janë shumë më të larta se ato të botës së jashtme.

Ushqimi që ju jepet nga Burgu është i njëjtë për të gjithë të paraburgosurit dhe të sëmurët apo diabetikët nuk marrin ushqim të veçantë të përshtatur për nevojat e tyre shëndetësore.

Krahas kushteve materiale dhe higjienike në paraburgim, ekipi i MPNSë vlerësoi edhe mundësitë për lëvizje jashtë qelive të personave të paraburgosur, sport dhe rekreacion.

Pas këqyrjes së kryer, me keqardhje mund të konstatohet se personat mbahen të mbyllur në qeli 23 orë në ditë, pra vazhdimisht, ndërsa kanë të drejtë në ajër të pastër deri në një orë, përkatësisht 45 minuta (sipas disa prej të arrestuarve). Kjo është shumë nën standardet, si vendore (të paktën dy orë në ditë - Neni 9 i Rregullores për Rendin shtëpiak për ekzekutimin e masave së paraburgimit³⁷), respektivisht sipas rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) që personat e paraburgosur duhet të kenë aktivitete të shpikura jashtë qelive të tyre deri në 8 orë ose më shumë, që përfshijnë aktivitete të një natyre të ndryshme: punë, arsim, sport, rekreacion.

Në INK Burgu Shkup, sidomos gratë – të paraburgosura nuk kanë kurrfarë aktiviteti/përmbytje të shpikur, përveç shëtitjes në rrethin e paraburgimit në kohëzgjatje prej më së shumti 1 orë.

Personave nga seksioni i paraburgimit ju lejohen vizitat, pranimi i pakove ushqimore dhe sendeve personale pas miratimit nga gjyqtari i procedurës paraprake. Megjithatë, **disa të paraburgosur u ankuan se nuk kanë kontakte me fëmijët e tyre, gjë që është veçanërisht e vështirë për gratë e paraburgosura.**

REKOMANDIME KYÇE:

- Të rishikohen kushtet e punësimit në institucionet penitenciare, kontrolli i të kaluarës së kandidatëve për pranim dhe trajnimi sistematik i kuadrit të sapopranuar;
- Të merren masa urgjente për përmirësimin e kushteve materiale, të nevojave të veçanta të grave të paraburgosura, si dhe një vlerësim të plotë të rrezikut për parandalimin e dhunës ndërmjet të paraburgosurve të vendosur në një qeli;
- Të respektohen plotësisht dispozitat në lidhje me përdorimin e mjeteve për lidhje gjatë përcjelljes;
- Të rritet cilësia e të urshqyerit duke ruajtur vlerat ushqyese, por edhe nevojat e të sëmurëve dhe atyre me regjim të veçantë (diabeti);
- Të respektohen standardet vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me të drejtën për ajër të pastër, sport dhe rekreacion.

³⁷ Rregullore e rendit të shtëpisë për ekzekutimin e masës së paraburgimit në seksionet e paraburgimit në burgje („Gazeta zyrtare e RMV-së“, nr.87/2020 e datës 02.04.2020)

3.3 INSTITUCIONI NDËSHKUES – KORREKTUES BURGU TETOVË

Burgu i Tetovës është një institucion ndëshkues – korrektues i llojit gjysëm të hapur me sigurim fizik të cilin e realizojnë pjesëtarët e Seksionit për sigurim.

Kapaciteti i Burgut është për 49 persona të dënuar, ndërsa në ditën e vizitës (10.08.2023) në burg ishin 59 persona të dënuar (prej tyre, gjatë vizitës, pesë ishin në pushim vjetor, dy shfrytëzonin fundjavë, ndërsa gjashtë ishin të angazhuar me punë jashtë burgut).

Numri i të punësuarve (Policia e Burgjeve dhe Sektori për Risocializim) edhe më tutje mbetet nën numrin e vendeve të punës të parapara me sistematizim, për këtë arsye nuk plotësohen nevojat për kryerjen normale dhe efikase të funksionit të institucionit të këtij lloji. Ende nuk ka të punësuar asnjë femër në Sektorin e sigurisë, ndaj mbetet në fuqi rekomandimi i dhënë pas vizitës së MPN nga viti 2018, **vetë fakti që policia e burgjeve nuk ka person zyrtar femër është problem serioz në kushtet kur duhet të kontrollohen femrat, andaj zyrtarët na theksuan se nuk i kontrollojnë femrat, edhe pse ndërkohë është blerë një detektor manual me të cilin çdo person që hyn në Burg kontrollohet nga jashtë. Përveç detektorit manual, Burgu ka edhe një skaner përmes të cilit kalojnë të gjitha sendet që futen.**

Problemi me mosplotësimin e vendeve të punës në institucionet ku kryhet heqja e lirisë është lëndë e shqyrtimit edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës, i cili në këtë kuptim thekson se: „... në vendet ku plotësimi i personelit është joadekuat, mund të lind nevoja për punë jashtë orarit për të ruajtur nivelin bazë të sigurisë dhe regjimit në institucion. Kjo situatë lehtë mund të rezultojë në nivele të larta stresi tek personeli dhe humbje të parakohshme të vullnetit të tyre për të punuar, gjendje që ka të ngjarë të përkeqësojë tensionet karakteristike për çdo mjedis burgu”³⁸.

Situata me INK Burgun Tetovë në vitin 2018 ka qenë shqetësuese për shkak se janë konstatuar një sërë situatash negative. Që atëherë, ekipi i MPN-së ka realizuar dy vizita të njëpasnjëshme (2021 dhe 2023), pas të cilave vërehen qartazi ndryshime pozitive, veçanërisht për sa i përket **kushteve materiale të Burgut, përkatësisht:**

1. Është bërë seksion i veçantë pranimi dhe është mobiluar me mobilje komode,
2. Qelitë e izolimit janë rinovuar,
3. Për të gjithë të dënuarit janë blerë dyshekë të rinj, bataniye dhe shtroje të tjera,
4. Banjot janë rinovuar tërësisht dhe janë pajisur me pjesë të reja sanitare: dushe moderne, ndërsa në proces është rinovimi i banjove që gjenden në pjesën e hapur të oborrit,
5. Oborri është tërësisht i rinovuar dhe i dekoruar në mënyrë të përshtatshme,
6. Palestra për personat e dënuar, si dhe dhoma e përbashkët për qëndrim ditor dhe biblioteka, janë pajisur me pajisje të reja dhe janë rinovuar,
7. Salla e ngrënies është rinovuar, ku të ushqyerit organizohet në grupe (për shkak të numrit të kufizuar të tavolinave dhe karrigeve). Mandej, kujdesen që në mesin e enëve të përdorura nga personat e dënuar mos të ketë thika,

³⁸ Ekstrakt nga Raporti i 11-të i përgjithshëm (CPT/Inf (2001) 16) i Komitetit kundër torturës i Këshillit të Evropës

8. Dhoma e vizitave është përshtatur dhe rregulluar plotësisht, tualetet (për burra dhe gra) dhe oborri i vizitorëve janë pajisur me mjete/pajisje për fëmijë.

E tëra kjo që është cekur më lart është zbatuar falë donacioneve nga persona/kompani të jashtme, për të cilat donacione janë përgatitur lavdërata dhe janë vendosur në vende ku shihen.

Seksioni i pranimit në burg përbëhet nga një dhomë me katër krevate, një dhomë e veçantë e për qëndrim ditor të pajisur me një divan dhe një pranues për televizor, tualet i cili gjatë vizitës ishte përmbytur për shkak të geshmes së lëshuar. MPN konstatoi se lokalet dukeshin të rregulluara me përjashtim të tualetit për të cilin është reaguar menjëherë.

Të gjitha dhomat e akomodimit ishin të rregulluara dhe të pastra (për higjienën kujdesen vetë të dënuarit, ndërsa të punësuarit i stimulojnë ata që të ngrisin higjienën në një nivel më të lartë me disa komoditete për dhomat më të pastra). Dhomat janë të pajisura me shtretër të pastër dhe në secilën prej tyre kishte pranues për televizor.

Tualetet në seksion janë rinovuar tërësisht dhe janë në gjendje të shkëlqyer. Gjithmonë ka ujë të ngrohtë dhe mjete higjienike, gjë që u cek nga të dënuarit me të cilët foli ekipi i MPN-së.

Për nevojat e personave të dënuar është vendosur telefon që mund të përdoret në çdo kohë dhe nga i cili mund të telefonohen numrat fiks dhe mobil.

Hapësira e destinuar për shetjetje në ambient të hapur të personave të dënuar, tanimë nuk njihet që nga vizita e vitit 2018 meqenëse është zbukuruar tërësisht me gjelbërim, lule dhe pishinë montuese. Në një pjesë të oborrit mbillen perime (domate), ndërsa higjiena dhe organizimi i përgjithshëm i oborrit ishte në nivel të lartë.

Një pjesë e oborrit është e mbuluar dhe e pajisur me tavolinë dhe karrige, të cilat ju mundësojnë të qëndrojnë jashtë edhe në ditët kur moti nuk e lejon atë (shi, borë). Gjatë vizitës, pikërisht në këtë hapësirë disa nga të dënuarit luanin lojëra shoqëruese.

Në kuadër të shëtitorës gjendet edhe e ashtuquajtura hapësirë e përbashkët ku personat e dënuar kanë mundësi të pinë kafe, çaj, të shikojnë TV dhe të shoqërohen së bashku. Dhoma është e pajisur me mobilje në gjendje të mirë, bar, frigorifer me plot pije freskuese, aparat për kafe dhe televizor, ndërsa pranë kesaj dhome ndodhet biblioteka, e cila si të tjerat dhoma ishte e pajisur me mobilje, në gjendje të mirë dhe të pastër. Ajo që mund të vihej re është fondi modest i librave.

Pranë këtyre dy dhomave ndodhen berberia (gjithashtu e rregulluar dhe e pajisur me mobilje në gjendje të mirë dhe me pajisje karakteristike për një punishte të këtij lloji), një sallë fitnesi e pajisur me pajisje më moderne, si dhe një klasë e destinuar për edukim.

Në këtë pjesë të Burgut ndodhet edhe banjoja, rinovimi i së cilës ishte në rrjedhë, ndërsa nga aktivitetet e punës që mundeshin të shihen, lirisht mund të konstatohet se edhe ajo do të jetë e pajisur në mënyrë moderne edhe me ambiente sanitare adekuate për një banjo moderne.

Në kuzhinë përgatitet ushqim për të gjithë personat e dënuar. Personi i angazhuar në kuzhinë është një kuzhinier profesionist dhe persona të dënuar që e ndihmojnë. Higjiena në kuzhinë është në nivel të kënaqshëm, e pajisur me mjete të kuzhinës në gjendje të mirë. Ushqimi përgatitet sipas menysë së përgatitur nga shefi i kuzhinës, ndërsa e firmos, respektivisht e miraton mjeku dhe drejtori. Për cilësinë e ushqimit, vetë të dënuarit kanë deklaruar se është i shijshëm dhe i mjaftueshëm, rregullisht shërbehen perime, ndërsa ajo që mungon janë frutat. Është vërejtur se nuk ka meny të veçantë për të dënuarit me dietë të veçantë (diabet, etj.). Personat e dënuar ushqimin e konsumojnë në menzë, e cila ka tavolina dhe karrige në gjendje

të mirë, të rregulluara dhe të pastra.

Në INK Burgu Tetovë është adaptuar një dhomë e veçantë për kryerjen e riteve fetare për personat e fesë islame.

Ambulanca ndodhet në bodrumin e institucionit ndëshkues – korrektues dhe është e pajisur me tavolinë pune dhe karrige, kompjuter, lavaman, shtrat ekzaminimi, vitrinë metalike të mbyllur për ruajtjen e barnave, si dhe vitrinë për ruajtjen e dokumentacionit mjekësor. Prej pajisjeve mjekësore ka kufje mjekësore (stetoskop), aparat për matjen e presionit të gjakut, aparat për EKG, aparat për matjen e sheqerit në gjak, teste për kontrollë të drogës. Edhe mëtutje nevojiten aparate për kontrollin e syve, veshëve, maskë oksigjeni, maskë AMBU për frymëmarrje të asistuar.

Mjeku i punësuar, njëkohësisht është përgjegjës edhe për SHEK Tetovë, ku qëndron çdo të enjte. Mjeku është në dispozicion çdo ditë nga e hëna deri të premten nga ora 08:00-16:00 me përjashtim të disa orëve të së enjtes kur viziton SHEK Tetovë. Mjeku jashtë orarit të rregullt të punës është në dispozicion edhe gjatë ditëve të javës deri në orën 22:00, ndërsa në raste urgjente thirren edhe ekipet e ndihmës së shpejtë mjekësore.

Mjeku e ndan ordinance edhe me dy të punësuar të tjerë të cilët janë gjithashtu të pranishëm gjatë ekzaminimeve, praktikë që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të cilat thonë se "Të gjitha ekzaminimet mjekësore (qoftë në pranim apo më vonë) duhet të kryhen pa praninë e zyrtarëve të burgut, përveç në raste kur mjeku kërkon ndryshe. Personat e dënuar duhet të ekzaminohen individualisht, jo në grup.³⁹"

Barëra në ambulantën e burgut nuk ka mjaftueshëm meqenëse vetë institucioni nuk ka buxhet për të dhe vetëm 5% e barnave të patjetërsueshme shpërndahen përmes Shtëpisë shëndetësore të Tetovës. Në rast nevojë për terapi sekondare ose terciare, pezullohet dënimi për aq kohë sa është e nevojshme të zgjidhet problemi shëndetësor. Personat e dënuar që nuk kanë sigurim shëndetësor nuk e marrin të njëjtën gjë as nga institucioni ndëshkues – korrektues, me fjalë tjera të njëjtit janë të pasiguruar.

Sa i përket shpërndarjes së terapisë për të dënuarit, duhet theksuar si praktikë pozitive dhe shembull për institucionet e tjera të burgjeve që në INK Burgu Tetovë terapia përgatitet veçmas për secilin të dënuar, e organizuar në pako të vogla në të cilat shënohet emri dhe mbiemri i të dënuarit pa theksuar se për çfarë lloj terapie bëhet fjalë, me ç'rast garantohet diskrecioni për pacientit dhe sëmundjen e tij, përkatësisht gjendjen e tij shëndetësore.

Nga bashkëbisedimi me mjekun, ekipi i MPN-së është njoftuar se në rast të konstatimit të lëndimeve të ndonjë i dënuar, mjeku për të njëjtin e informon drejtorin, por nuk ka informacione kthyesë vallë ato përcillen më tej tek Prokuroria publike, obligim që e ka drejtori kur konstaton lëndime të shkaktuara nga personi tjetër.

Në burg nuk ka asnjë ambulancë stomatologjike, poashtu as Burgu nuk ka lidhur marrëveshje me ndonjë institucion shëndetësor për ofrimin e shërbimeve stomatologjike për personat e dënuar. Personat e dënuar mjekohen tek stomatologu privat.

³⁹ Komiteti Evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues (KPT), Këshilli i Evropës, Shërbimi shëndetësor i burgjeve, i qasshëm në: <https://rm.coe.int/16806ce939> (Qasur me datë: 14.08.2023)

Në burg nuk vjen mjeku - specialist i psikiatrisë, por të dënuarit që kanë nevojë për psikiatër rregullisht dërgohen në Psikiatri në Qendrën Klinike të Tetovës.

Në seksionin e ekzaminimeve të personave të dënuar që janë në vuajtje të dënimit disiplinor – izolim, ekipi i MPN-së ka konstatuar se çdo person ekzaminohet nga mjeku para se të dërgohet në izolim, ndërsa mjeku i viziton rregullisht, në bazë ditore derisa janë në izolim.

Burgu disponon me më shumë kamera funksionale për **mbikëqyrje video** që monitorojnë muret e jashtme dhe hapësirat e brendshme të përbashkëta në institucion. Në këtë mënyrë është ngritur niveli i mbrojtjes nga veprimet e mundshme të papërshtatshme ndaj personave të dënuar, ndërsa incizimet nga vëzhgimi video shfrytëzohen edhe për konstatimin e gjendjes faktike në rastet e pretendimeve për shkelje disiplinore të kryera nga personat e dënuar.

Ekipi i MPN-së është informuar se nuk ka Rregullore apo çfarëdo dokument tjetër që rregullon çështjen e vëzhgimit me video në institucion. Strategjia për zhvillimin e sistemit penitenciar si një nga aktivitetet për realizimin e qëllimit strategjik të Fuqizimit të sistemit të video-mbikëqyrjes në INK dhe EEK (4.5) parasheh edhe miratimin e rregullave dhe futjen e POS për video vëzhgim në INK dhe EEK. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se një aktivitet i tillë ende nuk është zbatuar dhe ekipi i MPN nuk ka informacion se është miratuar rregullore e unifikuar apo POS për video-mbikëqyrjen në INK dhe IEK, dhe, **duke pasur parasysh nevojën për rregullimin e video-mbikëqyrjes në institucion, ekipi i MPN-së rekomandon si zgjidhje kalimtare të ndiqet shembulli i INK-ENK Idrizovë ku drejtori i institucionit, në bazë të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, ka miratuar "Rregulloren për mënyrën e kryerjes së video vëzhgimit në INK-ENK Idrizovë me repart të hapur në Veles" (Nr. 01-9450/1 të datës 19.08.2021)⁴⁰.**

Askush nga personat e dënuar me të cilët bisedoi ekipi i MPN-së nuk u ankua për **trajtim** jo të duhur nga ana e personave zyrtarë dhe as për padurim apo dhunë mes vetë të dënuarve. Të gjithë theksuan qëndrimin korrekt të të punësuarëve ndaj tyre, si dhe kushtet e mira materiale dhe ushqimin. E vetmja vërejtje në kontekst negativ është kujdesi shëndetësor dhe mungesa e barnave, veçanërisht për ata të dënuar që kanë edhe probleme/diagnoza psiqike/psikiatrike.

Gjatë pranimit në institucion, të dënuarit kontrollohen në 24 orët e para, përkatësisht nëse pranimi është bërë në orët e mbrëmjes, në mëngjes kontrollohen sapo vjen mjeku. Me këtë rast, ekipi i MPN-së thekson se kontrolli, gjegjësisht **ekzaminimi i të dënuarve të sapopranuar nuk duhet të bëhet duke i zhveshur plotësisht, por e njëjta gjë të bëhet pjesërisht (së pari pjesa e sipërme e rrobave dhe më pas duke e veshur atë pjesë, të kalohet në heqjen e pjesës së poshtme të rrobave). Mënyra e këtillë e kryerjes së ekzaminimeve ruan dinjitetin e personave - qëllim i ekzaminimit dhe nuk i ekspozon ndaj trajtimit apo ndëshkimit shtesë çnjerëzor ose poshtëruës. Çdo ekzaminim i kaviteteve të brendshme duhet të bëhet nga një person profesionist - mjek. Ky lloj ekzaminimi duhet të regjistrohet zyrtarisht me të dhëna për personin që kryen ekzaminimin dhe të tjerët të pranishëm gjatë kryerjes së tij.**

Të gjithë personat të cilët janë duke vuajtur dënim me burg kanë të drejtë të punojnë konform aftësive fizike dhe psikike. Personat e dënuar në ENP Burgu Tetovë më shpesh janë të

⁴⁰ I qasshëm në ueb faqen e ENK: <https://www.kpuidrizovo.gov.mk/2023/05/12/pravilnik-za-nachinot-narvshe%d1%9ae-na-video-nadzor-vo-kpu-kpd-idrizovo-so-otvoreno-oddelenie-vo-veles/> (herën e fundit është vizituar me datë 18.08.2023)

angazhuar në mirëmbajtjen e higjienës në ent, realizimin e punëve në kuzhinë apo detyrat e rregullta të rendit, kurse gjashtë persona të dënuar ishin të angazhuar jashtë entit ndëshkues-përmirësues.

Në ENP Burgu Tetovë, nuk realizohet **arsimi** fillor dhe i mesëm i obligueshëm, kurse në momentin e vizitës, personat e dënuar nuk ishin të kyçur në procesin arsimor jashtë Entit. **Me mënyrën e këtyrë të të vepruarit, enti i cenon të drejtat ligjore për organizim të arsimimit të obligueshëm si pjesë e sistemit të përgjithshëm arsimor dhe edukues.**

Gjatë kohës së bisedave të cilat i realizoi ekipi i MPN-së, asnjë nga personat e dënuar nuk u ankua në lidhje me të drejtën e **vizitës ose kontakteve** me familjen. ENP Burgu Tetovë ka siguruar hapësirë të veçantë për realizimin e të drejtës për vizitë të personave të dënuar, ka ndërtuar tualete për vizitorët (për meshkuj dhe për femra), gjithashtu është e rregulluar pjesa e jashtme (oborri) në aspektin hortikulturor me pajisje për fëmijë, disa paravanë për vizita gjatë periudhës së verës si dhe fontanë. Hapësira e këtyrë len përshtypje se vizitat ndërmjet të burgosurve dhe familjeve të tyre realizohen në mënyrë të dinjitetshme dhe të ndershme.

Ekipi i MPN-së konstatoi se në Burg ekzistojnë kuti të veçanta nëpërmjet të cilëve personat e dënuar mund të drejtohen me parashtrësë ose ankesë deri te drejtori ose deri te zyra e Avokatit të popullit, gjithashtu ishte vërtetuar se Rregullorja shtëpiake me të drejtat e personave të dënuar ishte vendosur në më shumë vende të dukshme në Burg.

Gjatë rrjedhës së vizitës, ekipi i MPN-së realizoi **biseda edhe me personat zyrtarë** të punësuar në Sektorin e Sigurimit. Edhe në këtë ent ndëshkues-përmirësues nevojitet ekipimi i personelit në pajtim me vendet e parapara të punës sipas sistematizimit. Megjithatë, në krahasim me vërejtjet e dhëna më herët, në këtë rast vëreheshte kënaqësi tek të punësuarit nga ndryshimet pozitive të cilat janë realizuar në Burg.

Personave të cilët punojnë në sigurimin e burgut, jashtë orarit të punës, u paguhet kompensim. Akoma kanë problem me uniformën, përkatësisht një kohë më të gjatë të punësuarit e sigurimit nuk marrin uniforma si dhe mbathje, dhe janë të detyruar të gjinden ashtu siç dinë dhe mendojnë.

Në ENP Burgu i Tetovës nuk ka asnjë të punësuar të gjinisë femërore në Sektorin e sigurimit. Prej këtij, mungesa e personave të gjinisë femërore të punësuar në Sektorin e sigurimit, sjell deri te situata, që kontrolli ndaj personave të gjinisë femërore – vizituese të burgut, të mos realizohet aspak, kjo nga ana tjetër vë në pikëpyetje çështjen e sigurisë në ent edhe pse për këtë qëllim shfrytëzohet detektor me dorë.

REKOMANDIME THELBËSORE:

- Rritja e numrit të zyrtarëve të burgut (në policinë e burgut dhe sektorin e risocializimit) dhe marrjen e masave në drejtim të sigurimit të më së paku një të punësuar të gjinisë femërore në ndërrim, në çdo kohë, në Burg;
- Respektimi i standardeve nacionale dhe ndërkombëtare gjatë realizimit të bastisjes/

kontrollimit të personit të ri të pranuar në ENP Burgu Tetovë⁴¹ ;

- Sigurimi i trajtimit të veçantë të ushqimit të personave të dënuar me nevoja të posaçme në të ushqyerit.

3.4 MBIPOPULLIMI DHE SITUATA E PËRGJITHSHME

Mbipopullimi edhe mëtutje paraqet një nga problemet me të cilin ballafaqohet sistemi maqedonas penitenciar. Mungesa e theksuar e hapësirës personale dhe privatësisë i vëndon në rrezik të gjithë personat e burgosur dhe të privuar nga liria, veçanësisht ata më të rrezikuarit/cenuarit.

Gati të gjitha entet ndëshkuese-përmirësuese përballen me mungesën e kapaciteteve për akomodim të personave të dënuar, të cilët janë udhëzuar në vuajtjen e dënimit me burg. Sipas të dhënave, me të cilat korrespondon ekipi i MPN-së, kapaciteti maksimal akomodues i enteve ndëshkuese-përmirësuese është për 2113 persona të dënuar, kurse nga ata vetëm në INK-ENK Idrizovë përfundimisht me datën 26.12.2023 janë vendosur 1297 persona⁴².

Gjatë rrjedhës së vitit 2023 u provua që të sillet ligj i ri për amnisti me të cilin duhet të përfshihen të dënuarit me aktgjykim të plotfuqishëm me burg për vepra penale të parapara me Kodin Penal ose me ligje tjera të cilët në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë filluar apo nuk kanë filluar me vuajtjen e dënimit me burg në ENP në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe persona të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm me dënim me burg për vepra penale të përshkruara me kodet penale të shtetit tjetër nëse autori është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe veprën e vuan në RMV në bazë të ekzekutimit të aktgjykimit penal të gjykatës së jashtme apo ndërkombëtare dhe i njëjti është pranuar me aktgjykim të gjykatës kompetente në RMV-së, në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ligji për amnisti nuk u aprovua nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë kohës së përgatitjes së këtij raporti, Ligji për amnisti ishte në procedurë parlamentare.

Në atë drejtim, **ekipi i MPN-së përsëri e thekson nevojën e zhvillimit të qasjes sistemore drejtë ballafaqimit me mbipopullimin në entet ndëshkuese-përmirësuese, nëpërmjet vendosjes së dialogut të përhershëm, mirëkuptimit dhe veprimit të pushtetit kompetent, udhëheqësit e Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve dhe enteve ndëshkuese-përmirësuese, ligjdhënësit, gjykatësit, prokurorët dhe të gjithë faktorët aktiv.**

Si vërejtje e përgjithshme në lidhje me funksionimin e sistemit penitenciar edhe gjatë këtij

⁴¹ Rregullat evropiane të burgjeve. E arritshme në: <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae> (Qasur më datë: 14.08.2023)

⁴² Të dhënat në mënyrë oficiale janë pranuar nga Drejtoria për ekzekutim e sanksioneve më datën: 12.03.2024, me shkresën nr.06-446/4.

viti ekipi i MPN-së konstatoi se ndërrimi i shpeshtë i personave udhëheqës në entet ndëshkuese-përmirësuese sjell deri te udhëheqja joligjore e të njëjtave, mungesa e shqyrtimit dhe realizimit të aktiviteteve dhe planeve të realizuara, si dhe mungesa e kontinuitetit gjatë realizimit të reformave të parapara me Strategjinë nacionale për zhvillim të sistemit penitenciar në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2025⁴³, pikërisht kjo strategji flet se kushtet për drejtor në ENP dhe EEK parashohin përvojë më së paku shtatë vite, nga të cilat katër në fushën e sanksioneve ose punëve të njashme. Procesi i këtillë është ngarkuar në mënyrë plotësuese me faktin se drejtorët emrohet drejtpërsëdrejti nga Qeveria me vendim për udhëheqës detyre, duke i ikur mënyrës publike dhe transparente për zgjidhjen e kuadrit profesional dhe me përvojë ashtu siç në shumë raste ekipi i MPN-së thekson në raportet e tij vjetore, por edhe Komiteti Evropian për parandalimin e torturës dhe veprimit jonjerëzor apo degradues ose ndëshkuese⁴⁴.

Pritet që ndryshimet dhe plotësimet e miratuara të reja të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve⁴⁵, të zgjidhin disa dilema edhe në lidhje me zgjedhjen dhe emërimin e kuadrit udhëheqës të Institucioneve ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese, por edhe në lidhje me vet menaxhimin, para së gjithash sigurinë. Megjithatë, si shumë herë deri tani, ajo që do të jetë e një rëndësie të veçantë është gatishmëria që në mënyrë konsekuente dhe në kohë të zbatohen zgjidhjet e tilla ligjore.

⁴³ Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, Strategjia nacionale e zhvillimit të sistemit penitenciarë në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2025, në dispozicion në: <https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2021/11/%D0%9D%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%BE%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%B2%D0%BE%D1%98-portain-10092021-MKD.pdf> (e disponueshëm më datë 23.03.2023)

⁴⁴ Report to the Government of North Macedonia on the visit to North Macedonia carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) from 7 to 9 December 2020, në dispozicion në: <https://rm.coe.int/1680a359cb> (e disponueshme më datë 22.03.2023)

⁴⁵ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve („Gazeta zyrtare e RMV-së” nr.74/2024) E arritshme në: <https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2024/04/%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD-%D0%B7%D0%B0-%D0%B8%D0%B7%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%B8-%D0%B4%D0%BE%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%BD%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%BD%D0%B0-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%BE%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D1%80%D1%88%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%B0%D0%BD%D0%BA%D1%86%D0%B8%D0%B8%D1%82%D0%B5.pdf> (Qasur më datë: 06.06.2024)

3.5 SHKALLA E REALIZIMIT TË REKOMANDIMEVE TË MEKANIZMIT PARANDALUES NACIONAL

Në lidhje me shkallën e respektimit të rekomandimeve të dhëna nga ana e Mekanizmit Parandalues Nacional deri te entet kompetente, e përshëndesim gatishmërinë që të korigjojnë mangësitë e konstatuara. Mirëpo, me keqardhje konstatojmë se entet e korigjojnë vetëm atë që nuk kërkon implikime financiare apo nevojë për koordinim me organe tjera (p.sh. Ministrinë e shëndetësisë, Ministrinë e arsimit dhe shkencës).



ENTET PSIKIATRIKE

Në vitin raportues Mekanizmi parandalues nacional vizitoi një ent psikiatrik, edhe atë Spitalin psikiatrik-Negorcë.

Ashtu si edhe vitin e kaluar, edhe gjatë këtij viti vizita e paparalajmëruar ishte në repartin forenzik, përkatësisht repartin gjyqësor dhe mënyra e të vepruarit me personat e privuar nga liria me masë të shqiptuar siguri-mjekim i obliguar psikiatrik dhe vendosje në ent shëndetësor.

Spitalet psikiatrike janë mjedise në të cilat personat të cilët mjekohen janë të ekspozuar në rrezik nga keqpërdorime që mund të nënkuptojë torturë apo ndonjë lloj tjetër i të vepruarit jonjerëzorë, nënvlerësues apo ndëshkues. Në atë drejtim janë edhe ndalesat e këtyre llojeve të keqpërdorimit të parapara me dokumentet ndërkombëtare dhe me rregullat nacionale⁴⁶. Kjo, e parashtrohet nevojën e monitorimit në kontinuitet, dhe për këtë shkak edhe ekipi i MPN-së spitalet psikiatrike i numëron në listën e vendeve tradicionale të cilat u nënshtrohen kontrolleve të rregullta⁴⁷.

Sipas standardeve të Komitetit Evropian për parandalim të torturës (KPT) resurset kadrovike duhet të përshtaten me numrin, kategorinë e personelit (psikiatra, mjekë të përgjithshëm,

⁴⁶ Në këtë drejtim është edhe Raporti i veçantë i Raportuesit special të mëhershëm për torturën (Huan E. Mendez) i vitit 2013: A/HRC/22/53 (në Raport pasqyrohen entet shëndetësore si vende ku ekziston rrezik i keqpërdorimit që do të thotë torturë ose veprim tjetër jonjerëzorë), Komiteti Evropian i parandalimit të torturës (KPT) ka zhvilluar standarde në drejtim të parandalimit të torturës në entet psikiatrike, kurse në rregullimin ligjor nacional ndalimi i mundimit theksohet në më shumë tekste ligjore, si për shembull Ligji për ekzekutimin e sanksioneve (neni 5).

⁴⁷ Ekipi i MPN-së Spitalin psikiatrik për herë të fundit e ka vizituar në dhjetor të vitit 2019 dhe për të njëjtën ishte dorëzuar edhe Raporti i veçantë. Pas kësaj vizite, përfaqësues të ekipit të MPN-së e kanë vizituar Repartin gjyqësor bashkërisht me përfaqësues të AP-së, të cilët punojnë në mbrojtjen e të drejtave të pacientëve në suaza të punës me lëndë, me qëllim grumbullimin e të dhënave për situatën e përgjithshme në repart. Kjo vizitë fokusoheshte vetëm në Seksionin për mjekim të personave të dënuar me çrregullime mentale ose të ashtuquajturin Departament gjyqësor, ku janë të vendosur persona të cilëve u është shqiptuar masa e sigurisë – mjekim i obligueshëm psikiatrik dhe mbajtje në ent shëndetësorë.

infermiere, psikologë, terapeutë profesional, punëtorë social etj.), përvojë dhe stërvitje. Mungesa e resurseve kadrovike shpeshherë mund të sjellin deri te situata të rrezikshme për pacientët, pa marrë parasysh qëllimet e mira si dhe përpjekjet e vërteta të personelit të shërbimit⁴⁸.

Në këtë drejtim **dhe në këtë rast edhe njëherë do ta përsërisim vërejtjen e përgjithshme e cila ishte konstatuar edhe vitin e kaluar, ajo është që edhe ky spital si edhe spitalet psikiatrike "Shkup" dhe "Demir Hisar" ballafaqohet në mënyrë serioze me mungesën e personelit. Kështu, në Spitalin psikiatrik – "Negorci" nga gjithsej 114 vende të sistematizuara të punës, 89 janë të plotësuar, si dhe një pozicion me kontratë në vepër.**

Sipas standardeve të Komitetit Evropian për parandalim të torturës (KPT) resurset kadrovike duhet të përshtaten me numrin, kategorinë e personelit (psikiatra, mjekë të përgjithshëm, infermiere, psikologë, terapeutë profesional, punëtorë social etj.), përvojë dhe stërvitje. Mungesa e resurseve kadrovike shpeshherë mund të sjellin deri te situata të rrezikshme për pacientët, pa marrë parasysh qëllimet e mira si dhe përpjekjet e vërteta të personelit të atij shërbimi⁴⁹, kurse për personelin **rreziqe që do të sjellin deri te mbingarkesa, rritja e stresit dhe rrjedhimisht deri te mundësia e shterjes së kapaciteteve të punëtorit, përkatësisht "djegie" (i ashtuquajtur i sindrom i burnout), e cila do të pasqyrohet edhe gjatë të vepruarit kundrejt pacientëve.**

4.1 IPSH SPITALI PSIKIATRIK "NEGORCI"

Spitali Psikiatrik "Negorci" është i ndarë në dy reparte edhe atë një me mbikëqyrje të përfurcuar rritur dhe një repart pa mbikëqyrje më të madhe. Sa i përket repartit gjyqësor (forenzik) i cili ishte edhe lëndë e kësaj vizite të MPN-së, gjithashtu është vendosur në një objekt të veçantë dhe në atë janë vendosur pacientë me masën e shqiptuar të sigurisë – mjekim të obliguar psikiatrik si dhe mbajtjen në ent shëndetësor.

Nga aspekti material, objekti është i ri dhe me tualete të rregulluara, dhoma individuale, në të cilat janë vendosur nga dy deri në tre pacientë dhe qëndrim ditor, në të cilat ka dy televizor si dhe me shumë lojëra shoqërore: letra (karta), tablo, shah.

Spitali nuk posedon ekonomi spitalore si një lloj i terapisë okupative për pacientët (edhe pse jo shumë më herët (përpara 5 viteve) e njëjta ka ekzistuar), nuk kanë donacione as edhe sigurim të jashtëm, nuk ekziston video-mbikëqyrje. Megjithatë, ka terren futbollit, basketbollit si dhe kantinë në hapësirën e spitalit ku pacientët furnizohen me ushqime, mjete për higjienë personale dhe veshmbathje

Ikje nga spitali ka (nga një në muaj), pas së cilës njoftohet stacioni kompetent policor e cila sipas rrëfimit të të punësuarve, përgjigjet sipas paraqitjes dhe është në ndjekje të pacientëve.

⁴⁸ European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT), CPT/Inf(98)12-part (Extract from the 8th General Report of the CPT), par. 42

⁴⁹ Ibid

Në lidhje me parkun e makinave, spitali posedon mjaftueshëm makina, me të cilat mund të plotësohen nevojat, dhe për të njëjtën shprehur kënaqësi edhe udhëheqësia.

Spitali nuk ka borxhe, kurse buxheti për vitin 2024 është rritur për 5 milion denarë në krahasim me vitin 2023.

Në repart në ndërrimin e parë ka infermiere dhe teknik medicinal, dhe pas përfundimit të ndërrimit të parë në ndërrim e dytë ka dy motra mjekësore. Mjek përgjegjës dhe udhëheqës i repartit është drejtori aktual i spitalit, i cili realizon mandatin e tij të dytë, i cili çdo ditë realizon mbikëqyrje ndaj të gjithë punës, kurse dy mjekë, të cilët janë në specializim të drejtimit, në kontinuitet e mbulojnë repartin, e vëzhgojnë gjendjen psikike dhe në koordinim me udhëheqësin e rregullojnë terapinë medikamentoze.

Një punëtor social i obliguar për të gjithë pacientët në spital, gjithashtu edhe për pacientët e repartit gjyqësor (në ditën e vizitës në spital kishte 38 pacientë me masën siguri mjekim i obliguar psikiatrik si dhe mbajtje në ent shëndetësor. Pacientët tjerë (gjithsej 11 pacientë) për shkak të përkufizimeve hapësinore janë të vendosur në reparte tjera. Me të gjithë pacientët në spital punojnë vetë dy psikologë.

Fiksimi në spital realizohet në repartin pranues ku për atë qëllim është siguruar hapësirë e veçantë, e siguruar me mure mbrojtëse dhe me mbikëqyrje nga të dyja anët e hapësirës në formën e mureve prej qelqi. Për fiksion shfrytëzohen rripe magnetike dhe për vet fiksionin është përgatitur Protokoll për fiksion të pacientëve në IPSH Spitalin Psikiatrik "Negorci", si dhe formular për fiksion, i cili përmban të dhëna për pacientin, historinë e sëmundjes, përshkrimin e gjendjes psikike, terapinë e ordinuar, llojin e fiksimit, kohëzgjatjen e fiksimit, kontrollën dhe personin udhëheqës, i cili e lejon fiksionin.

Për secilin pacient ekziston historik në të cilin janë shënuar të gjitha të dhënat, historia e sëmundjes, gjendja aktuale dhe e përgjithshme shëndetësore, si dhe të gjitha intervenimet mjekësore gjatë qëndrimit të tij në spital p.sh. të gjitha hulumtimet mjekësore të cilat janë realizuar gjatë hospitalizimit të tij, protokoll për mjekim, mendim dhe udhëzim nga psikologu, anamneza sociale dhe vërejtje të kohëpaskohshme për rrjedhën e gjendjes psikike.

Secili pacient ka edhe kartelën e tij shëndetësore, në të cilën regjistrohet i gjithë komunikimi me gjyqin për pacientin, mjekimi i tij, si dhe masat e propozuara (nëse i ka edhe atë rreth ndryshimit të masës)⁵⁰, kërkesë për fundjavë terapeutike ose kërkesë për ndryshim të masës në mjekim të obliguar ambulator.

Gjatë kohës së vizitës së repartit gjyqësor nuk kishte pacientë, të cilët janë me terapi me metadon.

Nga bisedat e realizuara me një pjesë të pacientëve mund të konstatohet se të njëjtit janë në gjendje stabile relative psikike me lista të rregullta terapeutike dhe me terapi adekuate.

Të gjithë janë të kënaqur me vendosjen, kushtet, ushqimin edhe pse kishte edhe pacientë të cilët u ankuan për të njëjtën. Pacientët i shprehën mundësitë që të furnizohen me disa gjëra nga kantina në rrethin e spitalit, posaçërisht i gëzon mundësia që dy herë në javë, me prezencë të të punësuarve, mund të komunikojnë me familjen dhe më të afërmit nëpërmjet telefonit.

⁵⁰ Gjatë bisedës me të punësuarit ishte theksuar se edhe pse spitali rregullisht i informon gjykatat, çdo gjashtë muaj, dhe për disa pacientë kanë propozuar kërkesë për ndryshim të masës së mjekimit të obligueshëm në kushte spitalore, mjekim në liri, gjyqi rrallë herë përgjigjet ndaj këtyre propozimeve dhe nuk realizon ndryshim të së njëjtës.

Nga mbikëqyrja e realizuar mund të konstatohet se **puna në repartin gjyqësor pranë IPSH Spitalit Psikiatrik "Negorci" realizohet papengesa dhe në kushte relativisht të mira materiale.** Të punësuarit shprehin përkushtim dhe përkujdesje për pacientët, kurse vet hapësirat në të cilat realizohet kontrolla e pacientëve janë të pastra dhe të pajisura.

Ajo që brengos është mungesa e aktiviteteve produktive, strukturore dhe të paramenduara të cilat do të kontribuojnë drejt përmirësimit të gjendjes së përgjithshme psikike të pacientëve, që rrjedhimisht do të kontribuojnë drejt risocializimit të tyre si dhe funksionimit produktiv pas përfundimit të masës.

Mungesa e terapisë punuese, si dhe këshillimit individual dhe grupor, terapisë konstruktive, si dhe aktiviteteve të rregullta sportive.

REKOMANDIM KYÇ:

- Punësimi i personelit plotësues në pajtim me sistematizimin e vendeve të punës, para së gjithash punëtorëve social si dhe psikologëve, por edhe mjek psikiatër-subspecialistë të psikiatrisë gjyqësore, si dhe terapeutë pune.



STACIONET POLICORE ME KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Gjatë rrjedhës së vitit 2023 ekipi i MPN-së realizoi 7 vizita në stacionet policore me kompetenca të përgjithshme, edhe atë SP KP Bit Pazar, SP KP Tetovë, SP KP Kriva Pallankë, SP KP Kavadar, SP KP Resnjë, SP KP Veles dhe SP KP Shtip, si dhe 2 vizita në stacionet policore për mbikëqyrje kufitare, SP MK Bllacë dhe SP MK Çashkë. Të gjitha ishin realizuar pa paralajmërim të mëhershëm

5.1 SP KP BIT PAZAR

Që nga themelimi i Mekanizmit Parandalues Nacional, Stacioni policor me Kompetenca të përgjithshme Bit Pazar ishte vizituar për të pestën herë.

Gjatë kohës së kësaj vizite ishte konstatuar se SP KP Bit Pazar edhe më tutje nuk ka të përshtatur hapësirë të veçantë për biseda me fëmijë, kështu bisedat me fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe me fëmijë viktime të veprave penale realizohen në zyrat e inspektorëve për delikuençë fëmijërore, kurse në raste të veçanta edhe në zyrën e udhëheqësit të ndërrimit. Zyra e inspektorëve për delikuençë fëmijërore (e cila gjindet në katin e parë të ndërtesës dhe nuk ka asensor sepse i njëjti është jashtë funksioni) është në gjendje të keqe materiale, e ndajnë më shumë inspektorë dhe është e pajisur me inventarë të vjetërsuar dhe vetëm me një kompjuter, i cili është i dedikuar për më shumë inspektorë. Muret janë të lyera me ngjyrë të bardhë, kurse përreth dritareve janë realizuar/improvizuar izolime me stiropor. Prej këtui ekipi i MPN-së konstatoi se **se zyra në të cilën realizohen bisedat me fëmijët në SP KP Bit Pazar jo vetëm që nuk është adekuate për qëllimin për të cilin përdoret, madje e njëjta nuk ka as kushte elementare për qëllimin e theksuar, respektivisht për punë pa pengesë.** Ekipi i MPN-së gjatë kohës së vizitës morri informacione se në situata të veçanta, kur kushtet e lejojnë atë, bisedat me fëmijët realizohen në zyrën e udhëheqësit të ndërrimit, e cila për nga aspekti

material ishte më e mirë sepse ka qenë e renovume nga ana e të punësuarve me mjetet e tyre.

Sa u përket hapësirave për ndalje, higjiena është në nivelin e duhur në krahasim me gjendjen e konstatuar gjatë vizitave të mëhershme të MPN-së, gjatë së cilës ishte theksuar se për mirëmbajtjen e higjienës në këto hapësira është angazhuar agjencion i posaçëm, i cili rregullisht i pastron hapësirat për mbajtje, dhe herë pas here i pastrojnë shtresat dhe mbulesat.

Duke u bazuar në informacionet e pranuar dhe sasinë e punës, ekipi i MPN-së konstatoi se numri i zyrtarëve policor të uniformuar në SP KP Bit Pazar nuk është i mjaftueshëm që të realizohen obligimet e tyre në mënyrë adekuate dhe pa pengesa, kurse mungesa e personelit ishte konstatuar edhe në pjesën e policisë kriminalistike.

Përskaj mungesës së zyrtarëve policor, ekipi i MPN-së në mënyrë plotësuese konstatoi se problem serioz paraqet edhe sistemimi i zyrtarëve policor në vende pune dhe realizimi i detyrave të punës për të cilat nuk janë të kualifikuar, përkatësisht nuk kanë përvojë paraprake, gjithashtu nuk kanë qenë të kyçur në problematikën (për shembull nëpërmjet trajnimeve etj.). Një pjesë të rotacioneve të këtylla të vendeve të punës zyrtarët policor i përfetojnë si kthim prapa në karrierën e tyre profesionale, për shkak të të cilës edhe motivimi i realizimit të obligimeve është në nivel shumë të ulët⁵¹.

E gjithë kjo drejtpërsëdrejti ndikon edhe në rrezikun e të vepruarit jo adekuat ndaj personave të privuar nga liria, dhe për këtë shkak ekipi i MPN-së rekomandon që secili transfer ose udhëzim i zyrtarëve policor në vende pune apo për realizimin e obligimeve të punës për të cilat nuk kanë përvojë paraprake të realizohet pas trajnimeve, nëpërmjet të cilave zyrtari policor do të njoftohet me specifikat në realizimin e autorizimeve policore karakteristike për atë vend pune. Njëkohësisht, ekipi i MPN-së rekomandon që secili transfer apo udhëzim i zyrtarëve policor në vende tjera pune që donë të thotë përparim apo kthim prapa në karrierën e tyre të bazohet veçmas në drejtim të profesionalizimit të funksionit, dhe të realizohet në procedurën dhe mënyrën e paraparë me ligj.

Për dallim nga kjo, ashtu siç gjendja e atillë e takuar faktike e cila ndikon në drejtim të zvogëlimit të rrezikut nga të vepruarit e mundshëm kundrejt personave të ndaluar, ekipi i MPN-së e veçon orvatjen e komandantit të stacionit policor që të gjithë bisedat me personat e ndaluar të realizohen ekskluzivisht në hapësirën e paraparë për atë qëllim e cila është nën video-mbikëqyrje të përhershme. Pikërisht, ekipi i MPN-së i thekson këto orvatje si praktikë pozitive e cila duhet të praktikohet edhe në stacionet tjera policore.

⁵¹ Shpeshherë për rotacionet e zyrtarëve policorë në suaza të Ministrisë së punëve të brendshme nga njëri në departamentin tjetër, sektor ose njësi organizative theksohet se nuk janë motivuar nga motive profesionale, por për shkak të ndonjë revanshizmi apo presioni

5.2 SP KP TETOVË

Stacioni policor me Kompetenca të përgjithshme (SP KP) Tetovë është vizituar për herën e tretë nga ekipi i MPN-së.

Edhe ky stacion policor ballafaqohet me mungesën e kuadrit, dhe mu për atë **Avokati i popullit si Mekanizëm parandalues nacional përsëri rekomandon rritjen e numrit ZPU në SP KP Tetovë, në përputhje me numrin e vendeve të punës sipas sistematizimit, deri në plotësimin e plotë të vendeve të punës sipas sistematizimit.**

Përskaj mungesës së zyrtarëve policor, **ekipi i MPN-së konstatoi se sfidë serioze paraqet edhe sistemimi i zyrtarëve policor në pozita pune dhe realizimi i obligimeve të punës për të cilat nuk kanë përvojë paraprake, gjithashtu nuk kanë qenë të kyçur në problematikën (për shembull nëpërmjet trajnimeve etj.).** Njëjtë edhe këtu do ta përsërisim rekomandimin e lartpërmendur se praktika **e atillë ndikon në rrezikun e të vepruarit të mundshëm jo adekuat ndaj personave të privuar nga liria, dhe për këtë shkak e rekomandojmë secili sistemim apo udhëzim të zyrtarëve policor në vende pune dhe realizim të detyrave të punës për të cilat nuk kanë përvojë paraprake të realizohet pas trajnimeve të mëhershme, nëpërmjet të cilave zyrtari policor do të njoftohet me specifikat në realizimin e autorizimeve policore, karakteristikë e vendit të tillë të punës.**

Stacioni policor është i pajisur me video-mbikëqyrje dhe gjatë realizimit të mbikëqyrjes në hapësirën e kujdestarisë ishte vërtetuar se e njëjta është funksionale. Funksionimi i video-mbikëqyrjes kontribuon jo vetëm për zvogëlimin e rrezikut nga veprimet joadekuate ndaj personave të privuar nga liria të cilat realizohen te Stacioni policor për shkak të bisedës apo ndalimit, por njëkohësisht e zvogëlon rrezikun nga akuzat e mundshme për veprime joadekuate nga ana e zyrtarëve policor.

Gjatë mbikëqyrjes së realizuar në një pjesë të zyrave zyrtare të zyrtarëve policorë ishte konstatuar se gjinden në gjendje relative të mirë materiale.

Stacioni policor disponon me dy hapësira për biseda të cilat janë të pajisura në mënyrë adekuate me karrige të fiksuara, tavolina, kompjuterë, si dhe video-mbikëqyrje. **Megjithatë, gjendja në lidhje me sigurimin e hapësirës së veçantë për biseda me fëmijë nuk është ndryshuar dhe vazhdon praktika që bisedat me ata të realizohen në zyrat e inspektorëve për delikuencë fëmijërore, e cila gjindet në katin e katërt.**

Stacioni policor disponon me tri hapësira për ndalim, prej të cilave dy janë me nga një krevat, kurse një me dy krevate. Krevatet në hapësira janë të përforcuara për dysHEMEJE, ishin të pajisura edhe me dyshek, batanije dhe jastëk, për të cilat ishte theksuar se lahen në intervale të caktuara kohore dhe se ndërrohen pas çdo qëndrimi të personit në hapësira. Gjatë ditës së vizitës në njërin nga hapësirat kishte person të ndaluar, i cili u ankua për papastërti sa i përket shtresës dhe mbulesës, si dhe për lagështi në dysHEMENË e hapësirës në afërsi të krevatit e cila dukeshë si urinë. Dy shishe me lëng të verdhë, sigurisht me urinë, ekipi i MPN-së i vërejtë edhe në tualetin e paraparë për personat e ndaluar. **Situata e këtillë tregon në atë që zyrtarët policorë nuk përgjigjen në kohë ndaj kërkesave të personave të ndaluar të dërgohen deri te tualeti i cili gjindet në afërsi të hapësirave për ndalim.** Në asnjë nga hapësirat nuk ka tavolinë dhe karrige, kurse në të gjitha hapësirat ka të instaluar sistem për thirrje dhe komunikim (domofon). **Megjithatë, nga mbikëqyrja e realizuar dhe kontrollimi i funk-**

sionalitetit të sistemit për komunikim, ishte konstatuar se i njëjti nuk funksionon në mënyrë adekuate. Hapësirat ajrosen dhe depërton mjaftueshëm drita gjatë ditës nëpërmjet dritareve të errësuar të cilat nga ana e jashtme ishin të siguruara me grila. Gjatë kohës së vizitës ishte konstatuar se në dy hapësira ka dritare të thyera, dhe për këtë shkak temperatura e matur ishte shumë e ulët (16oC). Situata e tillë ishte hasur edhe në hapësirën ku ishte vendosur personi i ndaluar, i cili ankohet se gjithë natën e ka kaluar në të ftohtë pa asnjëfarë ngrohje.

Në afërsi të hapësirave për ndalje gjindet edhe tualeti për personat e ndaluar i cili është i pajisur me sanitari adekuate, përkatësisht me guacë dhe lavaman prej metali dhe pasqyrë nga materiali i pathyeshëm. Gjatë kohës së vizitës ishte konstatuar se në tualet nuk kishte mjete për mirëmbajtjen e higjienës personale, si për shembull: sapun, letër tualeti e të ngjashme. Higjiena në tualet ishte relativisht e mirë.

Në stacionin policor, udhëzues me këshilla në lidhje me të drejtat e të thirrurve, të arrestuarve dhe personave të ndaluar në më shumë gjuhë (maq. shq. dhe ang.) janë vendosur në hyrje të Stacionit policor, në hapësirën e udhëheqësit të ndërrimit si dhe në hapësirat për biseda.

Nga bisedat me personat zyrtarë ishte theksuar se secili person, i cili është arrestuar apo privuar nga liria njoftohet me arsyet e arrestimit/të privimit nga liria dhe të ndalimit, me të drejtën që të angazhojë avokat, si dhe me të drejtën e ofrimit të ndihmës mjekësore. Përkaj këshillimit me gojë për këto të drejta, personave u jepet të nënshkruajnë formularë/këshilla me shkrim, të cilat gjoja udhëzojnë në faktin se personat janë këshilluar dhe njoftuar me të drejtat e tyre.

Në lidhje me qasjen deri tek e drejta e avokatit, përshtypja është se personat e ndaluar vetëm pyeten a duan të thirrën avokat pa mos u asistuar që në rastet kur nuk kanë kontakt nga avokati, t'u shpjegohet për mundësinë e thirrjes së avokatit nga lista e avokatëve kujdestarë, me të cilën madje zyrtarët policorë nuk disponojnë. Kur bëhet fjalë për fëmijë dhe kur është e patjetrueshme prezenca e avokatit, ishte theksuar se kontaktojnë disa avokatë, të cilët kanë kaluar trajnim të specializuar për punë me fëmijë. **Ekipi i MPN-së nuk konstatoi se inspektorët posedojnë listë të posaçme për avokatët, të cilët kanë kaluar trajnime speciale për punë me fëmijë. Njëkohësisht, ekipi i MPN-së e thekson rrezikun e paanshmërisë së avokatëve, posaçërisht në kushte kur gjithmonë kontaktohen të njëjtët avokatë.**

E drejta e mjekut për të arrestuarin, përkatësisht të privuarin nga liria dhe të ndaluarin në Stacionin policor ishte theksuar se realizohet nëpërmjet thirrjes së ekipit të Ndihmës së shpejtë mjekësore edhe atë me kërkesë të personit ose kur personi zyrtar do të vërtetojë se ka nevojë për atë. Ishte konstatuar se kontrollet mjekësore realizohen nën prezencë dhe video-mbikëqyrje të zyrtarëve policor. Duke e pasur parasysh nevojën e vendosjes së relacionit të drejtpërdrejt mjek-pacient, si dhe për shkak të nevojës së mbrojtjes së besueshmërisë mjekësore, **ekipi i MPN-së thekson se kontrollet mjekësore duhet të realizohen pa prezencë të mbikëqyrjes së zyrtarëve policor, përveç në raste të veçanta kur atë do ta kërkojë mjeku për shkaqe sigurie.**

Stacioni policor nuk ka buxhet për ushqim për personat e privuar nga liria si dhe për personat e ndaluar.

5.3 SP KP KRIVA PALLANKË

Stacioni policor me Kompetenca të përgjithshme Kriva Pallankë është vizituar tre herë nga ana e Mekanizmit parandalues nacional.

Vërejtje e përgjithshme është se edhe pse ndërtesa gjoja është rinovuar, megjithatë len përshtypje se është e vjetruar, kjo shihet nga mobilet që i posedon. Ekipi i MPN-së si brengë e thekson faktin që stacioni policor akoma është pa video-mbikëqyrje, nuk janë pajisur hapësira të posaçme për bisedë me të arrestuarit, të ndaluarit dhe personat e privuar nga liria, nuk ka hapësira për bisedë me fëmijë, gjithashtu edhe gjendja me numrin e të punësuarve të unifor-muar edhe më tutje nuk mjafton. Në mënyrë plotësuese, personat zyrtarë u ankuan edhe për mungesën e materialeve themelore për punë, si kompjuter, karrige për ulje e të ngjashme. Prej këtu, **ekipi i MPN-së konstatoi se Stacioni policor korrespondon me kushte të përkufizuara për funksionim normal të zyrtarëve policor gjatë punës. Ashtu siç ishte rasti edhe me stacionet e mëhershme policore, edhe këtu konstatohet mungesë e kuadrit.**

Gjatë mbikëqyrjes në hapësirën e udhëheqësit të ndërrimit ku më shpesh mbahen per-sonat e arrestuar, të ndaluar ose të privuar nga liria, **në mënyrë transparente nuk janë të vendosura udhëzimet për të drejtat e personave të privuar nga liria apo çfarë do lloj informacionesh.**

Ekipi i MPN-së ishte informuar se gjatë arrestimit të personit të cilit i nevojitet ndihma mjekësore, e njëjta i ofrohet në kohë dhe e njëjta evidentohet në regjistrat për evidencë, megjithatë zyrtari policor gjithmonë është prezent gjatë rrjedhës së kontrollës mjekësore, e cila është në kundërshtim me standardet e vendosura ndërkombëtare të cilat theksojnë se "Të gji-tha kontrollet mjekësore të personave në stacionet policore patjetër të realizohen pa prezencën e zyrtarëve për zbatim të ligjit, përveç nëse mjeku kërkon ndryshe në rast të caktuar"⁵².

Nga mbikëqyrja e realizuar në regjistrat për mjetet e detyrimit, por edhe nga biseda me personat zyrtar u vërtetua përdorimi i forcës fizike dhe çfarë do lloj tjetër i fiksimit të personave.

Kur bëhet fjalë për personat e ndaluar shtetas të huaj, ishte theksuar se zyrtarët policor personalisht kuptohen me ato. Në hapësirën e udhëheqësit të ndërrimit ishin vërejtur afishe me udhëzime për të drejtat e personave të ndaluar në më shumë gjuhë, por mënyra e këtitllë e informimit me të drejtat e këtyre personave pa mundësi reale që të komunikohet me të njëjtit **tregon për improvizim i cili nuk duhet të lejohet.**

Avokatët sipas detyrës zyrtare nuk vijnë, shfrytëzohen lidhje personale, shoqërore dhe në rast nevojë ata i ftojnë.

Ekipi i MPN-së nga kjo konstaton se nevojitet të formalizohet protokoll i stand-ardizuar për të vepruar në raste të këtitlla, si dhe listë me përkthyes të autorizuar, por edhe avokatë. Secili improvizim i panevojshëm mund të sjellë deri te shkelja e të drejtave të personave të ndaluar apo të privuar nga liria.

Personat zyrtarë në stacionin policor me të cilët ishte biseduar theksuan se personat gjith-monë informohen për arsyet e thirrjes, arrestimit apo privimit nga liria, gjithashtu informohen

⁵² Këshilli i Evropës-Ndryshime në lidhje me standardet gjatë ndalimit policor, i arritshëm në: <https://rm.coe.int/16806cd1ed> (08.06.2023)

edhe për të drejtat e tyre (të ftojnë avokat, të kërkojnë ndihmë mjekësore, të informojnë person të tretë).

As edhe në këtë stacion policor nuk ka buxhet për ushqim të personave të privuar nga liria dhe të ndaluar.

Stacioni policor nuk ka automjete transporti, adekuate për nevojat.

Duke e pasur parasysh se është konstatuar jokonzistencë në pjesën e trajnimeve, posaçërisht në drejtim të avancimit në detyrë të zyrtarëve policor, **ekipi i MPN-së rekomandon që secili transfer apo udhëzim i zyrtarëve policor në pozicione të punës dhe realizimi i obligimeve të punës për të cilat nuk kanë përvojë paraprake të realizohet pas trajnimeve nëpërmjet të cilave zyrtari policor do të njoftohet me specifikat e realizimit të autorizimeve policore. Kjo, posaçërisht është e rëndësishme kur bëhet fjalë për punë me kategoritë e personave që lehtë u cenohen të drejtat, p.sh. fëmijë.**

Ekipi i MPN-së, gjithashtu, në pajtim me nenin 10 të Konventës së KB kundër torturës, thekson se **përgjegjësit kanë për obligim të sigurojnë se arsimimi dhe informacionet në lidhje me ndalimin e torturës janë plotësisht të përfshira në trajnimin e personelit për zbatim të ligjit, përkatësisht zyrtarët policor dhe personat tjerë të cilët munden të përfshihen në paraburgim, marrjen në pyetje ose trajtim të cilit do qoftë individ, i cili i është nënshtruar cilës do forme të arrestimit, paraburgimit ose burgimit.**

Stacioni policor ka dy dhoma për ndalim të cilat gjinden në pjesën e bodrumit të ndërtesës, të dyja nuk janë adekuate për këtë qëllim, nuk kanë ndriçim natyrorë, as edhe ajrosje, as edhe ndriçim artificial, gjithashtu nuk kanë edhe sistem për thirrje.

5.4 SP KP KAVADAR

Edhe pse i rinovuar, stacioni policor është pa video-mbikëqyrje, gjithashtu nuk janë siguruar as edhe hapësira të posaçme për bisedë me të arrestuarit, të ndaluarit dhe personat e privuar nga liria. Kur bëhet fjalë për hapësira të posaçme për biseda me fëmijë, është konstatuar se bëhen përpjekje për sigurimin e hapësirës për atë qëllim, si dhe hapësirës për njohje/dallim. Sa i përket numrit të personave me uniformë të punësuar, lirisht mund të përfundohet se i njëjti edhe më tutje nuk i përmbush nevojat. Kur flitet për materialet për punë, si kompjutera e të ngjashme, ky stacion policor është i pajisur në mënyrë solide dhe nuk ishte theksuar asnjëfarë mungese. Sa i përket mjeteve të transportit/udhëtimit atë e përbëjnë vetura të vjetra dhe të prishura. Trajnime organizohen, por jo mjaftueshëm.

Ekipi i MPN-së konstatoi se Stacioni policor Kavadar disponon me kapacitete të kufizuara njerëzore për funksionim dhe punë normale edhe pse ka kushte solide materiale. Rekomandimi për instalim të video-mbikëqyrjes edhe më tutje qëndron në fuqi.

Në mënyrë plotësuese ekipi i MPN-së rekomandon që sa më herët të pajisen dy hapësirat e reja të parapara për biseda me fëmijë dhe njohje/dallim dhe të vendosen në funksion sa më parë.

Njëkohësisht, rekomandon realizimin e trajnimeve për obligime të veçanta poli-

core, posaçërisht kur bëhet fjalë për punë me kategoritë e personave që lehtë u cenohen të drejtat, p.sh. fëmijët.

Stacioni policor posedon pesë hapësira për ndalim, me nga një krevat, prej të cilave shfrytëzohen katër. Edhe pse të njëjtat në shikim të parë duken mjaftueshëm të mëdha, megjithatë nuk i plotësojnë standardet e aprovuara ndërkombëtare⁵³. Gjithashtu hapësirat nuk kanë ndriçim natyror, as sistem për ajrosje, as edhe ndriçim artificial, gjithashtu nuk kanë edhe sistem për thirrje.

Gjatë arrestimit të personit të cilit i nevojitet ndihmë mjekësore, e njëjta i ofrohet në kohë dhe e njëjta në mënyrë të rregullt evidentohet në regjistrat për evidencë. Gjatë kontrollës gjithashtu kujdesen që personi të mbetet personalisht me mjekun dhe të ofrohet hapësirë e mjaftueshme për privatësi e cila është në përputhje me standardet e vendosura ndërkombëtare të cilat përcaktojnë "Të gjitha kontrollet mjekësore të personave në stacionet policore patjetër të realizohen pa prezencën e zyrtarëve për zbatimin e ligjit, përveç nëse mjeku kërkon ndryshe në rast të caktuar"⁵⁴.

Nga mbikëqyrja e realizuar në regjistrat për mjetet e detyrimit, por edhe gjatë bisedës me personat zyrtarë nuk u vërtetua përdorimi i forcës fizike apo ndonjë lloj tjetër i fiksimit të personave.

Zyrtarët policor janë të informuar se avokatët kanë detyrim zyrtarë t' i përgjigjen thirrjes, kanë listë të avokatëve kujdestarë edhe pse nuk janë plotësisht të njoftuar për mënyrën se si janë të angazhuar të njëjtit dhe si i paguajnë shërbimet e tyre. Nuk ishin pranuar ankesa për bashkëpunim dhe veprim nga punëtorët social.

Kur bëhet fjalë për fëmijët dhe bisedat e realizuara me ta, inspektorët për fëmijë posedojnë listë me avokatë të trajnuar për të përfaqësuar fëmijët të cilët në Kavadar janë gjithsej dhjetë. Bashkëpunimi me Qendrën e punëve sociale dhe Prokurorinë publike është i mirë dhe nuk kanë ndonjë problem më të madh. Gjatë bisedës gjithmonë ftohen të gjitha palët e prekura (prindërit/kujdestarët, Qendra për punë sociale, Prokuroria publike, avokati), kurse kohëzgjatja e bisedës nuk është më e gjatë se 3 orë. Ndalje të fëmijëve në stacionin policor nuk ka.

Në këtë rast ekipi i MPN-së sugjeron se SP KP Kavadar duhet të vendosë procedurë/protokoll formal të standardizuar gjatë të vepruarit me fëmijë, ashtu si me kategori tjera të qytetarëve sepse secili improvizim i panevojshëm mund të sjellë deri te shkelja e të drejtave të personave të ndaluar ose të privuar nga liria.

Në këtë drejtim, nevojitet që Ministria e punëve të brendshme të parashohë dhe përpilojë udhëzime të qarta të cilat do ta njësojnë praktikën e të vepruarit të zyrtarëve policor me secilin grup të qytetarëve, posaçërisht kur bëhet fjalë për qytetarë të kategorisë të cilët lehtë rrezikohen (persona me nevoja të posaçme).

⁵³ Komiteti Evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit jonjerëzorë ose degradues ose ndëshkues (KEPT), "Ndalimi nga ana e policisë", <https://rm.coe.int/16806cea26> (17.07.2023)

⁵⁴ Këshilli i Evropës – Ndryshime në lidhje me standardet gjatë ndalimit nga ana e policisë. Në dispozicion në: <https://rm.coe.int/16806cd1ed> (08.06.2023)

5.5 SP KP RESNJË

Stacioni policor Resnjë edhe pse i rinovuar në vitin 2021/22 i njëjti akoma nuk ka hapësira për realizimin e bisedave me të arrestuarit, të ndaluarit dhe personat e privuar nga liria, të gjitha në drejtim të parandalimit të torturës dhe keqtrajtimet tjetër jonjerëzorë, nënvlerësues apo ndëshkues. Stacioni policor, gjithashtu nuk ka hapësira për biseda me fëmijë, si dhe hapësirë për njohje/dallim. Sa i përket numrit të të punësuarve, përkatësisht personave të uniformuar, lirisht mund të konkludohet se i njëjti edhe më tutje nuk është i mjaftueshëm. Ndërsa kur flitet për materialet e nevojshme për punë, si kompjutera e të ngjashme, ishte theksuar se të njëjtët nuk mjaftojnë. Nga e lartpërmendura, **ekipi i MPN-së konstaton se Stacioni policor disponon me numër të kufizuar të kapaciteteve njerëzore për punë dhe funksionim normal, nevojitet përmirësim edhe në pjesën e mjeteve materiale-teknike për punë (p.sh. kompjutera). Në mënyrë plotësuese, ky stacion policor nevojitet që të instalojë edhe video-mbikëqyrje e cila duhet të sigurohet dhe vendohet në përdorim sa më shpejtë, duke e pasur parasysh faktin se ky stacion policor ka hapësira për ndalim dhe realizon ndalim të personave të privuar nga liria.**

Prej këtui, rekomandohet që urgjentisht të merren masa për pajisjen e hapësirave për realizim të bisedave me personat e privuar nga liria, arrestuar dhe ndaluar, para së gjithash të pajiset hapësira për realizimin e bisedave me fëmijë.

Stacioni policor në dispozicion ka katër hapësira për ndalje me nga një krevat, prej të cilave shfrytëzohen tri. Nga mbikëqyrja e realizuar mund të konstatohet se hapësirat edhe pse duken ashtu siç u ka hije, megjithatë nuk i plotësojnë standardet e pranuar ndërkombëtare⁵⁵. Hapësirat gjinden në pjesën e bodrumit dhe me shkallë jo të pashme. Gjithashtu hapësirat nuk kanë ndriçim natyror, as ajrosje. Hapësirat kanë të instaluar sistem për thirrje, ashtu si edhe në të gjithë stacionin policor, edhe këtu nuk ka video-mbikëqyrje.

Në këtë pjesë nuk ekziston as tualet, dhe në rast të nevojës fiziologjike, personat e ndaluar i bien ziles dhe thirrën person zyrtar, i cili i shoqëron deri te tualeti në katin e parë.

Higjiena në hapësirat për ndalim ishte në nivel solid, për pastrimin e hapësirave kujdeset pastruesi i punësuar në stacionin policor, kurse shtresat/mbulesat dërgohen për pastrim çdo dy javë në hotelin e afërt, me të cilin stacioni policor ka lidhur kontratë për këtë qëllim.

Gjatë arrestimit të personit i cili ka nevojë për ndihmë mjekësore, e njëjta i ofrohet në kohë dhe në mënyrë të rregullt evidentohet në regjistrat për evidencë. Personi kontrollon nga mjeku pa prezencën e zyrtarëve policor, e cila është në përputhje me standardet e vendosura ndërkombëtare të cilat udhëzojnë "Të gjitha kontrollat mjekësore të personave në stacionet policore patjetër të realizohen pa prezencën e zyrtarëve për zbatim të ligjit, përveç nëse mjeku kërkon ndryshe në raste të caktuara"⁵⁶.

Nga mbikëqyrja e realizuar edhe në regjistrat për mjetet e detyrimit, por edhe nga biseda me personat zyrtarë nuk u vërtetua përdorim i forcës fizike apo ndonjë lloj tjetër i fiksimit të personave.

⁵⁵ Komiteti Evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimet jonjerëzorë ose degradues ose ndëshkues (KEPT), "Ndalimi nga ana e policisë", në dispozicion në <https://rm.coe.int/16806cea26> (17.07.2023)

⁵⁶ Këshilli i Evropës – Ndryshime në lidhje me standardet gjatë ndalimit nga ana e policisë. Në dispozicion në: <https://rm.coe.int/16806cd1ed> (08.06.2023)

Zyrtarët policor rregullisht i informojnë për të drejtën e avokatit, por nuk kanë mjaftueshëm informacione në lidhje me mënyrën, me të cilën rregullohet kompensimi.

Parku i makinave i këtij stacioni policor është solid. Trajnime realizohen, por jo mjaftueshëm konform trendeve të reja, p.sh. dhuna familjare. Prej këtui, **ekipi i MPN-së rekomandon realizimin e trajnimeve për detyra të veçanta policore, posaçërisht kur bëhet fjalë për punë me kategorinë e personave të drejtat e të cilëve lehtë cenohen p.sh. viktimat të dhunës familjare, fëmijët.**

5.6 SP KP VELES

Stacioni Policor Veles është plotësuar me 70% të zyrtarëve policorë të uniformuar, që është një numër i **pamjaftueshëm për kryerjen efikase dhe efektive të punëve të përditshme.**

Nga bisedat e realizuara me të punësuarit në këtë Stacion Policor, krijohet përshtypja e mospërfilljes së përgjithshme dhe zhgënjimit ndaj kushteve të punës, **pakënaqësi ndaj nivelit të përgatitjes dhe njohurive të saporekturuarve, që kanë njohuri dhe shkathtësi shumë modeste sa u përket punëve policore.**

Puna jashtë orarit paguhet vetëm për 32 orë. Orët shtesë të punës, mbi këtë numër, kompenzohen me ditë të lira, por për shkak të mungesës së kuadrove edhe këto ditë të lira nuk shfrytëzohen.

Ky Stacion Policor ballafaqohet me ikje të kuadrove, ku mes personave që largohen ka edhe zyrtarë policorë me përvojë.

Zyrtarët me të cilët bisedoi ekipi i MPN, u ankuan për mungesë uniforme, ndërsa kur bëhet fjalë për armatimin personal dhe mjetet e detyrimit, u tha se edhe pse kanë kërkuar të reja, ato nuk u janë dhënë.

Sa i përket shkallës së realizimit të trajnimeve, u shprehën se SP Veles mban Raport vjetor për trajnimet, por për shkak të koordinimit me Shkupin dhe mungesës së përgjegjësit për këtë aktivitet, trajnimet nuk zhvillohen në mënyrë të rregullt.

Ekipi i MPN-së edhe me këtë rast, thekson se **trajnimet e zyrtarëve policor janë të një rëndësie të veçantë, si në zbatimin e specifikave gjatë ushtrimit të kompetencave policore, ashtu edhe kur bëhet fjalë për punën me kategoritë e cënueshme të personave, p.sh. fëmijët. Mëtej, theksohet se autoritetet kanë obligim të sigurojnë që arsimi dhe informatat në lidhje me parandalimin e torturës të jenë plotësisht të përfshira në trajnimin e personelit për zbatimin e ligjit, përkatësisht zyrtarët publik dhe personat e tjerë që mund të përfshihen në paraburgim, marrje në pyetje dhe trajtim të cilit do individ, të ekspozuar në çfarëdo qoftë forme të arrestimit, ndalimit apo burgimit.**

Kur personat ndalohen, rallë shfrytëzohen mjetet e detyrimit, ndërsa më shpesh përdoren prangat. Shpesh kanë nevojë për asistencë të Ndihmës së shpejtë mjeksore, me ç'rast u theksua se gjatë kontrollit mjeksor thuasje çdoherë është i pranishëm një zyrtar i uniformuar. Prangimi i personit ndodh vetëm nëse i njëjti është agresiv dhe i agjituat, kurse prangimi zgjatë

deri sa i njëjti të qetësohet.

Ekziston lista e avokatëve kujdestarë, por jo dhe listë e përkthyesve, me çka zyrtarët policorë bëjnë atë që dinë dhe mund ta bëjnë.

Stacioni policor është i pajisur me mbikëqyrje të kamerave, sistemi për kontrollë është i centralizuar dhe askush nga vet Stacioni Policor nuk mund të ndërhyjë tek i njëjti, as edhe të modifikojë.

Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin me institucionet tjera, p.sh. Qendrat për Punë Sociale, u pohua se jo çdoherë vijnë përfaqësues nga QPS rajonale kompetente si pasojë e mjeteve financiare dhe transportuese nga ana e Qendrave.

5.7 SP KP SHTIP

Problemi i mungesës së kuadrove, që konstatohet në Stacionet policore të përshkruara më sipër në këtë raport, vërehet edhe në këtë Stacion policor. Respektivisht, krahasuar me situatën me numrin e përgjithshëm për vitin 2019, gjatë kësaj vizite **u vërejtë reduktim i numrit të përgjithshëm të zyrtarëve policorë për 9. Kjo situatë edhe njëherë vërteton konstatimin e dhënë më parë që është në kundërshtim me standardet e Unionit Evropian⁵⁷.**

Në aspektin material, duhet vënë në dukje se ky Stacion policor ndodhet në një gjendje jashtëzakonisht të pakënaqshme. Për nevojë të rinovimit, përmes informimit të problemit nga MPB, kryeshefi ka njoftuar disa herë, por nuk ka marrë një përgjigje.

Përshtypja e përgjithshme që fitohet gjatë vizitës për rreth e qark Stacionit policor është për një nivel të lartë të mos higjienës, neglizhencë (në shumë vende nëpër zyra janë të mbingarkuar me letra të vjetra, kablo, kompjuter të vjetruar dhe sende të tjera). Kjo pasqyrë e braktisjes së mbeturinave vërehet kudo, dhe mbi të gjitha në zyrën për shkurorëzim, zyrën për kujdestari, shkallët që të çojnë nga zyra e marrjes në pyetje dhe bisedë, në zyrën për paraburgim. Në këtë pamje të keqe kontribuojnë korridorret e errëta dhe të pandriçuara.

Ky Stacion policor nuk disponon me hapsirë të veçantë për mjete të konfiskuara, kurse hapsirat e magazinës janë vend për mbeturina. Situata me objektet sanitare është katastrofale.

Nga bisedat e realizuara me të punësuarit në këtë Stacion policor të krijohet përshtypja e një ngathtësie të përgjithshme dhe zhgënjimi ndaj kushteve të punës, pakënaqësi për nivelin e përgatitjes dhe njohurive të kuadrit të saporekrutuar.

Për mungesë të uniformave u ankuan zyrtarët me të cilët bisedoi Ekipi i MPN-së, ndërsa për armatimin personal dhe mjetet për detyrim, u tha se edhe pse janë kërkuar të reja, të njëjtat nuk janë marrë.

Sa i përket nivelit të zbatimit të trajnimeve, u potencua se SP Shtip mban Raport vjetor për trajnim, zhvillohen trajnime për tema që kanë të bëjnë me kodin etik, kompetencat policore,

⁵⁷ Në kuadër të Unionit Evropian raporti mesatar është 318 zyrtarë policorë për 100,000 banorë. Të dhënat janë shkarkuar nga Eurostat, të disponueshme në <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/ddn-20190104-1>

dhunën në familje, përdorimin e mjeteve për detyrim, me grupet e cënueshme të qytetarëve, ndërsa dy herë në vit shkojnë në gjyajtje, edhe pse këtë vit e kanë anashkaluar gjyajtjen pranverore.

Gjatë arrestimit të personave, mjetet për detyrim shfrytëzohen rallë, ndërsa prangat janë ndër më të përdorurat. Shpesh kanë nevojë për Ndhimën e shpejtë mjeksore, me ç'rast u theksova se gjatë kontrollit pothuasje gjithmonë është prezent një person i policisë me uniformë. Prangimi i personave realizohet vetëm kur personi është agresiv dhe i trazuar, kurse prangimi zgjat deri sa i njëjti të qetësohet.

Stacioni policor Shtip, nuk ka buxhet të veçantë për ushqim për personat e ndaluar dhe personat e privuar nga liria.

Kanë pasur një listë të avokatëve kujdestarë, por e njëjta tanimë nuk shfrytëzohet (është e tjetërsuar) nuk kanë as listën me përkthyes, me çka veprojnë si dinë dhe sipas situatës.

SP Shtip, nuk posedon hapsirë të veçantë për bisedë me fëmijë, kështu bisedat realizohen në zyrën e inspektorëve për fëmijë, që është e papërshtatshme për këtë qëllim.

Stacioni policor është i pajisur me mbikëqyrje të kamerave, sistemi për kontrollë është i centralizuar dhe askush nga vet Stacioni policor nuk mund të ndërhyjë tek i njëjti, as edhe të modifikojë.

Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin me institucionet tjera, p.sh. Qendrat për punë sociale, u pohua se bashkëpunimi është i mirëfillt dhe çdoher kur kanë nevojë për të njëjtin ata vijnë.

Në këtë Stacion policor autoparku është në gjendje të vështirë, i njëjti posedon vetëm një automjet "Shkoda Jeti", automjete tjera për ndalim apo për transport nuk kanë.

Stacioni policor nuk disponon as aparaturë për testim të alkoolit.

5.8 SP MK ÇASHKË DHE BLLACË

Në këto dy stacione policore vihet në pah mungesa e kuadrove për mbikëqyrje kufitare. Kështu, edhe pse çdo stacion policor në veçanti duhet të disponojë me 56 persona, të dy stacionet funksionojnë me gjysëm kapacitet. Informatë shqetësuese është se shkaku i shfrytëzimit të shpeshtë të pushimeve mjeksore dhe pushimeve vjetore, as ata zyrtarë policor, të cilë janë të përcaktuar në këto dy stacione policore, nuk janë plotësisht në dispozicion.

Ky numër i të punësuarve, në këto dy stacione policore, nuk është aspak i mjaftueshëm dhe po të kemi parasysh mjetet materiale teknike që janë vënë në dispozicion, konkluzioni është se asnjë nga këto dy stacione nuk ka kapacitet për të përmbushur aktivitetet themelore dhe qëllimi për të cilin egzistojnë është mbikëqyrja e territorit të Maqedonisë në kufi me Kosovën.

Kjo situatë përkeqësohet nëse marrim parasysh faktin se të dy Stacionet policore kanë në dispozicion vetëm një automjet ("Dacia Dasta"), që transporton të punësuarit që punojnë me turne 12 orëshe. Pra, gjatë ndërrimit të turneve, jo vetëm që nuk ka automjet për Stacionin policor, por në ato pak orë "vakum" (pa automjetin transportues dhe pa të punësuarit) nuk ka

fare mbikëqyrje kufitare.

Patrullimi kufitar kryhet në këmbë në një grup prej dy zyrtarëve. Moto-patrullim nuk ka shkak i arsyeve të lartpërmendura.

Ndonëse në të dy stacionet policore është gjetur një qen i policisë, i trajnuar për patrullimin dhe zbulimin e lëvizjeve dhe transportit të paligjshëm të mallrave, për faktin se nuk ka zyrtarë të autorizuar si udhërfyes, i njëjti qen është lënë në vete dhe në harresë. Pikërisht për këto arsye, qeni në SP MK Çashkë, u gjet në një gjendje të palakmueshme, i sëmurë, i lodhur dhe i harruar në kutinë e tij (kutia e mbushur me jashtëqitje që vërteton konstatimin se sa gjatë ka qëndruar në kuti pa u ecur). Kjo situatë është e pajustificuar, me çka jep përshtypjen për një sjellje të pamatur dhe jonjerëzore, ndonëse kemi të bëjmë me kafshë. Kjo, sidomos, nëse merret parasysh se për këto qenë janë ndarë fonde nga buxheti i shtetit për blerjen dhe trajnimin e tyre.

Fakti i mungesës së ujit të pijshëm në këto dy stacione policore është shqetësues, veçanërisht situata në SP MK Çashkë, flet dhe vet fakti se në këtë Stacion policor nuk ka një pikë uji, mobiljet janë të vjetëruara dhe të rrënuara, mbeturina ka kudo, madje edhe në pyellin pranë Stacionit policor. Në pyetjen se pse është kështu, të punësuarit u përgjigjën se një kohë të gjatë nuk ka pastrures. Megjithatë, **mungesa e pastruesit nuk e justifikon ndotjen e mjedisit hapësinor dhe hedhjen e pamatur të plehrave dhe mbeturinave kudo.** Për krahasim me SP MK Bllacë, ku nuk ka pastrures, për higjienën e përditshme në vet Stacionin policor dhe mjedisin kujdesen të punësuarit, zyrtarët janë të rregulluara dhe të pastra, ndërsa oborri i rregulluar me hortikulturë. Të punësuarit kanë rënë dakord me Pastrimin komunal që mbetjet të hidhen në një kontejner të posaçëm, që merret dhe pastohet nga punonjësit e Pastrimit komunal.

Rruga deri te Stacionet policore është e vështirë për t'u aksesuar, rrugë malore (e shkelur, me baltë dhe vështirë e kalueshme), në veçanti në dimër, kur ka borë dhe kur kushtet për lëvizje janë të vështira.

Në SPMK Çashkë nuk punon mbikëqyrja e kamerave, për dallim të mbikëqyrjes së kamerave në SPMK Bllacë e cila është në funksion.

Situata në aspektin material në SPMK Bllacë është më e mirë. Armët rruhen siç duhet, të vendosura në një magazinë të posaçme, e rregulluar me alarm dhe kod. Hapësiat zyrtare dhe ndihmëse janë të pastra.

Megjithatë, **në të dy Stacionet policore të punësuarit u ankuan për sigurinë personale për shkak të vendndodhjes dhe qasjes së vështirë tek ata në rast të ndonjë incidenti.** Në mënyrë plotësuese, për këtë kontribuon mungesa e kuadrove, mjeteve materiale-teknike dhe transportuese, krahas kësaj situatë ka dyshime se në këtë pjesë të kalimit kufitar kryhet transporti i paligjshëm i gjithë llojeve të mallrave, me ç'rast vazhdimisht qarkullojnë grupe, që pikërisht për shkak të aktiviteteve të tilla (mallrave që bartin) paraqesin rrezik për jetën e të punësuarve.

Në këto dy Stacione policore, të punësuarit gjithashtu u ankuan për mungesë të uniformave, trajnimeve, përgatitjes dhe trajnimit të dobët të kuadrit të saporekrutuar.

Stacionet policore për mbikëqyrje kufitare nuk janë të përcaktuara si Stacione policore ku bëhet ndalimi i personave, për çka në raste kur ka nevojë të ndalohet ndonjë person i arrestuar apo i privuar nga liria, e njëjta zbatohet në Stacionin policor me Kompetencë të përgjithshme në Gjorge Petrov (nëse është i arrestuar, përkatësisht i privuar nga liria në SP MK Çashkë ose në

Seksionin policorë në Mirkovcë (nëse është i arrestuar, përkatësisht i privuar nga liria në SPMK Bllacë).

5.9 SITUATA TJERA TË KONSTATUARA

Krahas shqyrtimit të marrëdhënies dhe veprimit ndaj personave të privuar nga liria, përgjatë vizitave, ekipi i MPN-së zhvilloi bisedë me zyrtarë policor në baza individuale dhe konfidenciale lidhur me kushtet për punë, atmosferën, nivelin e kënaqësisë etj.

Si ekip, tashmë në disa raste kemi konstatuar kushte të papërshtatshme në të cilat punojnë zyrtarët policor (materiale dhe ndërnjerëzore), si dhe presione dhe ndikime, ndaj të cilave janë të ekspozuar, gjatë kryerjes së detyrave të tyre të punës.

Prandaj, me këtë rast edhe njëherë theksojmë nevojën që MPB-ja të shpeshtojë komunikimin dhe të përmirësojë bashkëpunimin me zyrtarët policor, me qëllim të rritjes së besimi reciprok dhe në këtë mënyrë të inkurajimit të zyrtarëve policor për të denoncuar presionet, ndikimet dhe kërcënimet ndaj të cilave janë të ekspozuar.

Fatkeqësisht, përsëri konstatojmë një nivel të lartë të dorëheqjeve tek një numër i madh i zyrtarëve policor, shkak i kushteve të punës dhe atmosferës në të cilën ata funksionojnë çdo ditë. Një farë kënaqësie u shpreh në pjesën e uniformave dhe pajisjeve personale që janë shpërndarë, por njëkohësisht, u shprehën se **gjatë kryerjes së punëve të përditshme, përballen me mungesa të shumta të kushteve themelore dhe mjeteve materiale-teknike.**

Ekipi i MPN-së, në një pjesë të Stacioneve policore, konstatoi se zyrtarët policor punojnë në kushte nënstandarde. Rritja e pagave thuajse nuk ka ndikuar në përmirësimin e standradit të tyre, duke pasur parasysh nivelin e rritur të harxhimeve ditore, përkatësisht inflacionin në vend. Në këtë kuptim, në disa Stacione policore u theksua kufizimi dhe pamundësia e realizimit të punës jashtë orarit, si dhe ankesat për dërgim në punë jashtë orarit vetëm për zyrtarë të caktuar policor.

Ngjashëm sikur në vitin paraprak raportues, edhe gjatë vitit 2023, në disa Stacione policore morrën informata se vendimet për degradim/avancim në karrierën e zyrtarëve policor apo emërime në pozita drejtuese janë të motivuara nga arsye të tjera, jo gjithmonë profesionale.

Duke pasur parasysh faktin se trajtimi me personat e thirrur, të ndaluarit, të privuarit nga liria dhe të ndaluarit në Stacion policor lidhen drejtpërdrejtë me kushtet e punës dhe atmosferën punuese, ku zyrtarët policor kryejnë detyrat e tyre, Ekipi i MPN-së thekson nevojën për investime të vazhdueshme për përmirësimin e kushteve në të cilat punojnë zyrtarët policor, respektimin e vazhdueshëm të rregulloreve ligjore që i referohen forcimit të integritetit dhe rritjes së profesionalizmit, duke përfshirë edhe kufizimin e mundësive për keqpërdorime të autorizimeve policore, ndërsa rekomandon ndërmarrje të masave urgjente, me çka do t'u mundësohet ndihmë dhe mbështetje psikologjike zyrtarëve policor.

REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME VIZITAT E STACIONEVE POLICORE NË VITIN 2023

- Rritje e numrit të zyrtarëve policor të uniformuar në Stacionet policore në përputhje me sistematizimin përkatës të vendeve të punës, si dhe zbatim i rregullt i trajnimeve të kuadrit vijues, por parasëgjithash, për të saporekrutuarit apo zyrtarët policor të përcaktuar në vende të reja të punës (kjo vlen veçanërisht për inspektorët për delikuecë të miturit);
- Në Stacionet policore ku nuk ka mbikëqyrje të kamerave apo sistemi i thirrjeve është i ndërprerë, instalim të mbikëqyrjes së kamerave dhe riparim të menjëhershëm të problemit (defektit);
- Rritje e numrit të automjeteve zyrtare në Stacionet policore në pajtim me nevojat;
- Në pajtim me Ligjin për të drejtat e fëmijëve, në çdo Stacion policor duhet të rregullohet një zyrë për bisedë me fëmijët;
- Përcaktimi i Listës së avokatëve kujdestarë si dhe përkthyesve, por edhe vendosja e protokoleve të formalizuara kur është i nevojshëm përdorimi i tyre;
- Gjatë kontrollit të personave të ndaluar, të arrestuar dhe të privuar nga liria, të garantohet raporti mjek-pacient, përkatësisht të sigurohet privatësia dhe diskrecioni pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të zyrtarëve policor.



MONITORIMI I SITUATAVA ME MIGRIMIN ILEGAL

Ekipi i MPN-së konstaton se njëra nga politikat e organeve shtetërore në përpjekjen për të kontrolluar flukset e parregullta të migrantëve, është vazhdimi i afatit të vlefshmërisë së Vendimit, që konstaton ekzistimin e gjendjes së rrezikut në një pjesë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut edhe atë në zonat kufitare jugore dhe veriore të RMV-së, shkaku i rrezikut të lartë të rritjes së numrit të hyrjes dhe kalimit të migrantëve nëpër territorin e RMV-së⁵⁸.

Në bazë të marrëveshjeve dypalëshe me më shumë shtete, në territorin e RMV-së janë të pranishëm zyrtarë të huaj policor, të cilët ndihmojnë focat policore të vendit në përballjen me migrimin ilegal, ndërsa u hap një mudësi shtesë për angazhim të zyrtarëve policor të huaj me nënshkrimin e marrëveshjes me FRONTEX⁵⁹.

Ndryshe nga zyrtarët e huaj policor të angazhuar në bazë të marrëveshjeve dypalëshe me shtetet nga të cilat vijnë dhe që nuk kanë imunitet të garantuar për procedurat e ndërmarra prej tyre (Njoftim i dërguar nga MPB me kërkesë të MPN-së i regjistruar nën nr.regj. 22.5-372/1 më datën 03.01.2022), pajisjet dhe zyrtarët e angazhuar në kuadër të aktiviteteve FRONTEX gëzojnë privilegje dhe imunitete të posaçme, të përcaktuara me Marrëveshjen me FRONTEX (neni. 12)⁶⁰. Pyetja që vjen rrjedhimisht është nëse garantimi i privilegjeve dhe imunitetit të tillë, mund të ndikojë në detyrimin për kryerjen e një hetimit efektiv në rastet e ekzistimit të pretendimeve për torturë ose trajtim apo veprim tjetër mizor, jonjerëzor ose poshtërues, një detyrim që RMV-ja e ka sipas Konventës kundër torturës, meriton vëmendje⁶¹.

⁵⁸ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” Nr. 72/21, 88/21, 274/21 dhe 146/22

⁵⁹ Marrëveshja e nënshkruar mes R. Maqedonisë së Veriut dhe Agjencisë së Kufirit Evropian dhe Rojës Bregdetare (FRONTEX) më datën 26 tetor 2022

⁶⁰ Marrëveshja e R. Maqedonisë së Veriut dhe Agjencisë për Kufirin Evropian dhe Rojet Bregdetare (FRONTEX) – e disponueshme në: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-12896-2022-init/en/pdf> (qasëse nga: 22.03 .2024)

⁶¹ Kërkesa zyrtare si parakusht për hapjen e hetimit dhe fillimin e një padie paraqet shkelje të nenit 12 të Konventës kundër torturës, shiko më shumë: OXFORD University Press: „The United Nations Convention Against Torture and its Optional Protocol: A Commentary“, Second Edition, Edited by M. Nowak, M. Birk, G. Monina, 2019, p.342

Në këtë kuptim, në kuadër të vizitës studimore që në vitin 2023, Mekanizmi parandalues nacional e realizoi me Republikën e Polonisë, me ç'rast vizitoi MPN-në e Polonisë, u zhvillua takim pune me përfaqësuesit e Zyrës për të Drejtat Themelore të FRONTEX (Fundamental Rights Officer (FRONTEX), ku u bisedua për mënyrën e veprimit sipas parashtresave për incidente serioze dhe njoftime mbi të njëjtat, ndjekja (monitorimi) i të drejtave themelore të migrantëve, si dhe për aktivitetet konkrete që FRONTEX i zbaton në Maqedoni.

Kështu, në fund të vitit 2023, me iniciativë të FRONTEX, u propozua nënshkrimi i një Memorandumi për mirëkuptim, përmes së cilit në mënyrë të dialoguar do të përmirësohen marrëdhëniet mes Avokatit të popullit dhe FRONTEX. Në pajtim me dinamikën e rregullimit reciprok të propozim-tekstit të memorandumit, i njëjti duhet të nënshkruhet në vitin 2024.

6.1 MBAJTJA DHE AKOMODIMI I MIGRANTËVE/SHTETASVE TË HUAJ DHE AZILKËRKUESVE

AP-MPN i kushton kujdes të veçantë dhe në mënyrë të vazhdueshme ndjek trajtimin e migrantëve, përkatësisht shtetasve të huaj dhe azilkërkuesve në vendet ku ata akomodohen dhe mbahen. Këto persona janë në pozitë të veçantë cenueshmërie duke pasur parasysh se janë jashtë vendeve të origjinës apo kombësisë dhe nuk janë të njohur me kontekstin ligjor dhe gjuhën e shtetit ku ndodhen. Një pjesë e madhe prej tyre përjetuan përvoja të gjata dhe traumatike gjatë udhëtimit të tyre, ndërsa disa prej tyre edhe në vendet e origjinës u larguna për shkak të përndjekjeve, shkeljeve të rënda të të drejtave njerëzore apo konfliktit.

Në vitin 2023, ekipi i MPN-së realizoi 3 vizita në vendet ku akomodohen dhe mbahen shtetasit e huaj dhe azilkërkuesit. Kështu, janë vizituar Qendra transitore për pranim "Tabanoc", Qendra transitore për pranim "Vinojug" dhe Qendra për pranim të shtetasve të huaj në Gazi Babë.

Krahas vizitave, ekipi i MPN-së merr informata të rregullta nga organet shtetërore dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë komunikon me përfaqësues të organizatave të vendit dhe ndërkombëtare për pjesën e trajtimit të migrantëve, përkatësisht shtetasve të huaj dhe azilkërkuesve. Në këtë kuptim, ekipi i MPN-së konstaton se gjatë vitit 2023 janë regjistruar rreth 10.350 persona, për të cilët është konstatuar se kanë status të parregulluar, përkatësisht vendqëndrim në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

6.2 QENDRA PËR PRANIM TRANSITOR (QPT) - "TABANOC"

Nga biseda e realizuar me persona të autoizuar të Ministrisë për punë të brendshme dhe persona të autorizuar të Ministrisë për punë dhe politik sociale (MPPS) si dhe vizitave të Qendrës për pranim, ekipi i MPN-së konstatoi se nuk ka ndryshime sa i përket situatës së fundit të atakuar më parë, me çka është e qartë se Qendra për pranim, funksionon si Qendër e llojit të hapur. Gjithashtu, u vërejtë një prezencë dhe aktivitet i reduktuar i organizatave ndërkombëtare

dhe civile, që në të kaluarën kishin përfaqësues të tyre në terren.

Nga biseda me përfaqësuesit e MPB-së, u konstatua se ende nuk janë përcaktuar rregulla për hyrjen dhe qëndrimin në Qendër, gjë që le mundësinë e keqpërdorimeve të mundshme të kompetencave (deri diku) diskrecionale të zyrtarëve policor, që janë në turne. Nga informatat e marra **mund të konstatohet se në praktikë u lejohej të gjithë personave që shprehin qëllimin e tyre për të qëndruar në Qendër, dhe që janë pa dokument për identifikim.**

Ndryshe nga personat që nuk posedojnë dokumente për identifikim, ata persona që do të kapen me dokumente personale dhe të njëjtit mund të identifikohen, u dorëzohen Inspektorëve kompetent për shtetas të huaj, të cilët pastaj veprojnë duke zbatuar procedurat për konstatimin e hyrjes së mundshme të paligjshme dhe qëndrimin në shtet. Kjo mënyrë e veprimit çon në një situatë paradoksale, me çka ata që kanë dokumente dhe ata të cilët mund të identifikohen në mënyrë të besueshme, nuk u lejohej qëndrimi në Qendrën transitore për pranim, ndryshe nga ata të cilët nuk kanë ose pretendojnë se nuk kanë dokument për identifikim.

Nga ana e personave zyrtarë të MPB-së, u theksua se askujt nuk i kufizohet liria dhe mund të largohet nga qendra në çdo kohë. Forcë dhe mjete për detyrim aspak nuk përdoren, por edhe nuk ka pasur nevojë për një gjë të tillë.

Nga biseda me përfaqësuesit e MPPS-së, u konstatua se vazhdon praktika që çdo person i ri, i pranuar në Qendër, fillimisht profilizohet përmes një bisede të drejtpërdrejtë, ku gjatë bisedës kuptohen edhe nevojat e këtyre personave. Personat e ri të pranuar njoftohen me mundësitë që kanë, përkatësisht për të parashtruar kërkesë për pranim të së drejtës për azil, për çka u theksua se nuk ka një interes të madh. Në kushte kur ka fëmijë të pashoqëruar, të njëjtëve u caktohet kujdestarë.

6.3 QENDRA E PËRKOSSHME TRANSITORE (QPT) - "VINOJUG"

Krahasuar me vitet e kaluara, personat që u takuan në Qendrën transitore për pranim nuk qëndrojnë gjatë në Qendër, gjë që tregon një periudhë qëndrimi dukshëm më të shkurtër. Gjithashtu, zyrtarisht asnjërit prej personave nuk i është kufizuar liria e lëvizjes me çka mund të largohen kur të duan nga Qendra. Azilkërkuesit presin të transferohen në Qendrat për pranim të azilkërkuesve në Vizbeg, ndërsa pjesa tjetër e intervistuar, pohuan se ata janë aty me vullnetin e tyre të lirë.

Kjo tregon për një situatë ndryshe nga ajo e hasura vitin e kaluar, me çka personat që ishin të akomoduar këtu, nuk kishin njohuri se pse mbaheshin, as edhe sa gjatë do të mbaheshin. Ka ndryshuar dhe situata në raport me lirinë e lëvizjes, domethënë ndryshe nga e kaluara, kur personat theksonin se nuk gëzojnë lëvizjen e lirë nëpër qendër, por, vetëm tek pjesa e toaletit, madje dhe atëherë në mbikëqyrje të përfaqësuesve të URM-së dhe MPB-së, gjatë vizitës së fundit të ekipit të MPN-së, u vu re një atmosferë më relaksuese.

Nga informatat me të cilat disponon ekipi i MPN-së, për dallim me të kaluarën, kur personat e regjistruar si migrant me "vendqëndrim jo të rregullt në Territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut", për të cilët autoritetet hetuese vendosën se kanë nevojë për të dëshmuar për procedura penale për persona të tretë (kontrabandistë) dhe mbaheshin në QPT-"Vinojug", tani

personat nuk mbahen por vetëm transportohen- në Qendrën për pranim për shtetas të huaj në Gazi Babë, Shkup.

Ekipi i MPN-së vërejtë një ndryshim të vogël në pjesën e trajtimit të personave të tjerë të regjistruar si migrantë me hyrje të paligjshme ose me vendqënim të parregulluar/paligjshëm në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. U vërejtë se pas marrjes së gjurmëve të gishtërinjve të këtyre personave në kuadër të QPT-së- "Vinojug", të njëjtit njoftohen për mundësinë e procedurave për njohjen e të drejtës për azil. Konsiderohet se ndryshimet e këtilla, janë kryesisht për shkak të prezencës së përfaqësuesve të FRONTEX në këtë qendër, pasi në kuadër të ekipeve të tyre disponojnë me përkthyes dhe ndërmjetës dhe kanë të drejtë për kontakt me personat që u merren shenjat e gishtërinjve.

E lartpërmendura, vërteton rritjen e numrit të kërkesave për azil. Kështu, krahasuar me vitin 2022, ku nga gjithsej 173 ("168") kërkesa të parashtruara për të drejtën për azil, afër 80 ishin të parashtruara në QPT- "Vinojug" në vitin 2023, deri në ditën e vizitës, nga rreth 563 kërkesa të parashtruara në gjithë territorin, rreth 188 janë parashtruar në QPT -"Vinojug"⁶².

Pas marrjes së gjurmëve të gishtërinjve, po shmanget praktika paraprake e përcjelljes me vetura zyrtare të migrantëve deri në pikat e caktuara në linjën e gjelbërt kufitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut me shtetet fqinje.

Gjatë vizitës **ekipi i MPN-së, edhe njëherë konstatoi rekomandimin e dhënë në disa raste për largimin e automjeteve të sekuestruara dhe të rrënuara nga qendra, përkatësisht vendosjen e tyre në lokacion adekuat. Nga ana tjetër, sfidë serioze edhe më tej mbetet mungesa e automjeteve adekuate për transport të personave, për çka po zvarriten procedurat për transport të azilkërkuesve deri në Qendrën transitore për pranim të azilkërkuesve në Vizbeg.** Njëkohësisht, duhet të kemi parasysh dhe nevojën për transport adekuat të kategorive vulnerabël të migrantëve (për shembull fëmijëve të shoqëruar, viktimave potencial të trafikimit me njerëz dhe ngjashëm).

Në pjesën e shëndetit mendor dhe nevojave psikosociale, nga fokus grupet e realizuara, situata tregohet e përmirësuar në aspektin psikosocial të personave, krahasuar me vitin e kaluar. Nga intervista me personat kompetent, mund të konstatohet se ndryshimet janë pasojë e ndryshimeve procesuese të personave të atakuar dhe rritjes së lirisë së lëvizjes. Si ndihmë e rëndësishme në përballimin e problemeve, paraqitet mbështetja e personelit lokal, mundësia për kontakt me familjet dhe miqtë, si dhe fokusi i tyre drejt së ardhmes dhe rrujtjen e një qëndrimi optimist.

Në bazë të gjendjes faktike të konstatuar, në përgjithësi, **ekipi i MPN-së mund të vërejë se situata në terren ka ndryshuar në aspektin pozitiv, si dhe në aspektin e koordinimit të organeve dhe organizatave të ndryshme prezente në terren, ashtu edhe sa i përket veprimit dhe trajtimit të personave të akomoduar në Qendër, që në mënyrë të drjepërdrejtë reflekton edhe ndaj shëndetit të tyre mendor.**

Në pjesën e kushteve materiale, ekipi i MPN-së edhe më tej mbetet me qëndrimin se QTP-"Vinojug", nuk duhet të shfrytëzohet për akomodime afatgjate. Nevo-

⁶² Këto janë shifra të disponueshme për ekipin e MPN-së bazuar në informacionin e marrë nga burime të ndryshme, të cilat mund të jenë të ndryshme nga zyrtarët nën MPB, siç janë të dhënat zyrtare të përfshira në raportin vjetor të MPB-së në vitin 2022, ku është theksuar se "Në Sektorin për Azil janë pranuar 168 kërkesa për pranim të së drejtës për azil ". Raporti është i disponueshëm publikisht në faqen e internetit të MPB-së.

ja e gjetjes së alternativave për akomodim të kategorive vulnerabël të migrantëve mbetet në fuqi.

6.4 QENDRA PËR PRANIM TË SHTETASVE TË HUAJ-“GAZI BABË”

Qendra për pranim të shtetasve të huaj vazhdon të përballet me problemin e punësimeve, gjë që u konstatua gjatë vizitës së fundit të ekipit të MPN-së në vitin 2022. Rreth gjysma e sistematizimit të vendeve të punës, nuk janë të plotësuara, kurse kuadri aktual paraqet vetëm njëzet përqind të numrit të përgjithshëm të vendeve të planifikuara të punës. Mes vendeve të lira për sistematizimin e vendeve të punës është edhe ai i psikologut. Mungojnë zyrtarë policor, inspektor, nuk ka as edhe numër të mjaftueshëm të personave zyrtar të gjinisë femërore. Numri i vogël i zyrtarëve policor, mund të ndikojë në cilësinë e komunikimit me gratë e ndalura në Qendër, por edhe të paraqes sfidë në lidhje me ofrimin e sigurisë së shtetasve të huaja të gjinisë femërore duke qenë se numri i tyre nuk duhet neglizhuar.

Mungesa e personelit, në përgjithësi, paraqet problem serioz, me çka rëndon funksionimin normal në Qendrën për pranim dhe reflekton në trajtimin ndaj personave të ndaluar dhe aftësinë e tyre për të shfrytëzuar të drejtat e tyre⁶³. Në raport me vitin e kaluar, kur u konstatua se nuk janë zhvilluar trajnime, këtë vit situata ka ndryshuar, me çka është përpiluar një Plan vjetor për trajnime dhe është dërguar pranë RCGS “Sever” (Veri) organ përgjegjës për organizimin e trajnimeve.

Sa i përket gjendjeve të konstatuara më parë, në pah janë ndryshime të dukshme të një rëndësie të veçantë nga aspekti material, poashtu kemi rregulla të reja për vendosje të një rendi dhe disipline në Qendër. Qendra ka miratuar Rregullat e reja të Shtëpisë, në pesë gjuhë të ndryshme edhe atë: gjuhë shqipe, gjuhë arabe, gjuhë frenge, gjuhë angleze dhe gjuhë turke. Nga vërejtjet e dhëna të ekipit të MPN-së për qasje tek e drejta për avokat dhe lista e avokatëve në dispozicion, Qendra për pranim është drejtuar deri te Dhoma e avokatëve, nga ku ka marrë Listën e avokatëve të disponueshëm në çdo qytet të shtetit. Për fat të keq, Qendra për pranim, nuk ka listë të përkthyesve të autorizuar, me çka të njëjtit thirren nga Shërbimi Jezuit për Ref-ugjatë.

Ndonëse nuk janë ndërmarrë aktivitete për dislokimin e Qendrës, gjatë kësaj vizite ekipi i MPN-së, konstatoi përmirësim të kushteve brenda mundësive të Qendrës, përkatësisht, krijimin e një qëndrimi më human të personave të akomoduar këtu. Kështu, njëra nga hapësirat që shërbente për qëndrim ditor për gratë e ndaluara në qendër, tani është kthyer në dhomë ngrënie dhe është vendi i vetëm ku shërbehet ushqimi (nuk hahet më nëpër dhoma). Ushqimi sillet nga Ministria e punëve të brendshme (detyrimisht ka një vakt të ngrohtë). Në këtë hapsirë ka edhe televizor, që të lën përshtypje të një atmosfere si në shtëpi dhe të ngrohtë.

Nyjet sanitare janë rregulluar dhe të disponueshme për përdorim të rregullt dhe ngrohja qendrore është funksionale. Depot pastrohen dhe organizohen, në mënyrë që të bëhet më i

⁶³ Në këtë kuptim u theksua se njëra nga arsyt që personave të ndaluar nuk u mundësohet e drejta për shëtitje në ajër të pastërt..

lehtë dhe më i qartë kërkimi i materialeve të nevojshme. Të gjithë shtretërit kanë dyshek të rregulluar dhe me mbulesa të pastërta.

Përkatësisht, edhe mëtej mbetet konstatimi se Qendra për pranim nuk është e përshtashme për personat me aftësi të kufizuara dhe rekomandohet që mos të dërgohen, pranohen dhe akomodohen persona me aftësi të kufizuara në të njëjtën. Gjithashtu, qendra nuk i plotëson kushtet as edhe për akomodimin e fëmijëve, me çka rekomandohet të mos dërgohen, pranohen dhe akomodohen këtu. Kur kemi të bëjmë me fëmijë të pashoqëruar, autoritetet duhet të marrin parasysh qëndrimin e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve të paraqitur në Komentin e Përgjithshëm nr. 6⁶⁴.

Ekipi i MPN-së konsideron se Qendra për pranim nuk ka kushte (si kadrovike ashtu edhe materiale) për akomodim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, gjatë periudhës së rikuperimit dhe refleksionit për çka konsideron se është më mirë në raste të tilla, në pajtim me rregulloret ligjore, të shfrytëzojnë kapacitete akomoduese të cilat janë nën kompetencë të Minsitrisë për punë dhe politikë sociale ose eventualisht, për raste të caktuara, "Shelter Qendra" të drejtura nga organizata joqeveritare dhe ndërkombëtare në kuadër të juridiksionit të tyre dhe mundësive për akomodim të personave viktimas si pasojë e tregtisë me qenie njerëzore.

Baza për akomodimin dhe kohëzgjatjen janë çështje të intersimit të vazhdueshëm të personave të akomoduar dhe mungesa e informatave për të njëjtën tek personat manifestohet përmes shqetësimit, nervozës, ankthit, depresionit dhe ngjashëm. Ekipi i MPN-së gjatë vizitës konstatoi se asnjë person i akomoduar në Qendër për pranim, nuk kishte me vete aktvendimet në bazë të akomodimit dhe mbajtjes në të.

Duke pasur parasysh se nga afati i pranimit të Aktvendimeve për akomodim/mbajtje filon edhe afati i parashtrimit të një mjeti juridik kundër një aktvendimi të tillë, ekipi i MPN-së konsideron se çdo personi që akomodohet-mbahet në Qendrën për pranim duhet t'i jepet aktvendim individual/vendim për të njëjtën, të informohet me gojë me përmbytjen e të njëjtit, si dhe për mundësinë e parashtrimit të mjetit juridik por edhe të kërkohet ndihmë juridike, si dhe është e nevojshme të evidentohet se kur është bërë e njëjta.

Për të drjetën e personave të paraburgosur për të kontaktuar dhe angazhuar një avokat, si dhe për të drejtën për ndihmë juridike, ekipi i MPN-së u informua se personat e paraburgosur njoftohen për këto të drejta përmes përfaqësuesve të organizatave civile dhe ndërkombëtare.

E drejta e personave të paraburgosur për të njoftuar një të afërm apo palë të tretë me vullnetin e tyre nga pikëpamja normative, rregullohet me dispozitatat e Rregullores për Rendin shtëpiak, që i referohet të drejtës për shfrytëzim të telefonit. Përkatësisht, në Rregullore, mes tjerave, është parashikuar që menjëherë pas akomodimit në Qendrën për pranim personi „*mund të shfrytëzojë tre telefonata falas, përkatësisht të kontaktojë përfaqësinë diplomatike-konsullin e shteit nga vjen, anëtarët e familjes dhe avokatin*“, me çka "telefonata mund të zgjasë më së shumti 5 minuta"⁶⁵.

⁶⁴ Komenti i Përgjithshëm nr.6 i Komitetit të UE për të Drejtat e Fëmijëve, pjesë 61, e disponueshme në: <https://www2.ohchr.org/english/bodies/crc/docs/GC6.pdf>

⁶⁵ Rregullorja për Rendin shtëpiak të Qendrës për pranim të shtetsave të huaj („Gazeta zyrtare e RMV-së“, nr. 93 e datës 07.04.2020)

Ekipi i MPN-së, konstatoi se Qendra për pranim mundëson kontaktin me telefon me familjarët e afërm deri në tre herë në muaj, ndërsa vet qendra ka rrjetin e internetit, që mundëson komunikimin e pandërprerë online.

Organizata që ofron mbrojtje shëndetësore është e pranishme tri ditë në javë, me terapi bazë farmakologjike, e mbuluar me mjete për ndihmë nga organizata. Për nevoja shëndetësore urgjente, personeli i institucionit mbështetet në shërbimet e ndihmës urgjente publike të shëndetit. Në rastet e nevojës për kujdes të specializuar, shpenzimet për shërbimet shëndetësore bien në kurriz të Ministrisë për punë të brendshme. Sa i përket mbrojtjes shëndetësore, institucioni nuk ka krijuar bashkëpunim formal me Ministrinë e shëndetësisë.

Nga intervistat dhe në fokus grupet e kryera, personat e ndaluar nuk evidentuan ndonjë reagim të fortë negativ me rëndësi klinike sa i përket qëndrimit të tyre në institucion. Situata aktuale tregon për një gjendje psikologjike të mirrëfilltë të personave të akomoduar në krahasim me vitet paraprake.

Mbetet edhe mëtej përshtypja se personat e ndaluar nuk kanë zbavitje, aktivitete për të përmbushur produktivisht kohën e tyre, po edhe nuk lejohen të dalin në ajër të pastër. Ata as nuk lëshohen jashtë për t'u shëtitur në oborrin e qendrës. Kjo situatë është shqetësuese dhe mund të ndikojë shumë në shëndetin mendor të personave të ndaluar, përkatësisht në rritjen e ankthit, depresionit, pakënaqësisë dhe nervozizmit.

Nga situatat e konstatuara gjatë kësaj vizite **ekipi i MPN-së edhe mëtej, tregon për nevojën e rritjes së numrit të të punësuarëve dhe personave të autorizuar, veçanërisht të gjinisë femërore.**

Të punësurit në Qendrën për pranim të përfshihen në sistemin e trajnimeve të rregullta dhe rifreskimit të njohurive. Me rëndësi të veçantë është përfshirja e temave me qasje traumatike-informative në punë, aftësive të komunikimit kulturor dhe gjinor, menaxhimin e stresit, njohja e standardeve ligjore dhe procedurave operative dhe ngjashëm.



IP ENTI PËR MBROJTJE DHE REHABILITIM “BANJA BANSKO”

IP Enti për mbrojtje dhe rehabilitim përbëhet nga dy objekte, njeri objekt është lëshuar në përdorim që në vitin 1974, ndërsa objekti i dytë (për banim individual) në vitin 2020.

Krahas këtyre dy objekteve, në oborrin e institucionit ka një objekt të posaçëm ndihmës-dhomë për larje dhe dhomë për tharje, si dhe objekt tjetër ndihmës ku ndodhet kazani i ngrohjes qendrore.

Enti i ofron shërbimet si vijojnë:

- Akomodimin;
- Infermierinë dhe kujdesin 24 orë (ushqimin, veshjen, higjienën dhe ngjashëm);
- Kujdesin parësor shëndetësor;
- Arsimin fillor;
- Terapinë fizikale dhe rahabilitimin;
- Risocializimin dhe mbështetjen profesionale;
- Shoqërimin jashtë Entit.

Në momentin e vizitës së Entit, takuam 46 shfrytëzues, nga të cilët 39 shfrytëzuese që janë në institucion (nga ato 19 janë gra ndërsa 20 janë burra) dhe 7 (5 gra dhe 2 burra) janë të deinstitutionalizuar dhe të akomoduar në Seksionin për jetesë të pavarur me mbështetje, 5 persona në njësitë banesore në Strumicë dhe 2 në njësinë banesore në f. Dobrejci. Në institucion ka edhe një shfrytëzues pa një Aktvendim për akomodim.

Për sa i përket kohëzgjatjes së akomodimit në institucion, 5 shfrytëzues kanë qëndruar deri në 10 vjet, 11 me qëndrim 10 deri 20 vjet, 9 shfrytëzues me qëndrim 20 deri 30 vjet dhe 20 shfrytëzues me qëndrim më të gjatë se 30 vjet.

7.1 PERSONELI DHE KUSHTET MATERIALE

Në pajtime me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin publik Entin për mbrojtje dhe rehabilitim "Banja Bansko"⁶⁶, në gjithsej 33 vende pune, pritet të punësohen 57 punonjës. Numri i kuadrit, në ditën e vizitës së Ekipit të MPN-së, ishte 37 punonjës. Institucioni shërbehet edhe nga kuadri teknik ndihmës.

Procesi i punës në Ent bëhet me turne, edhe atë turni i parë nga ora 07:00 deri në ora 15:00, turni i dytë nga ora 15:00 deri në orën 21:00, ndërsa turni i tretë nga ora 15:00 deri në orën 07:00 të mëngjesit të nesërm.

Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës i referohet mungesës së kuadrit teknik ndihmës, situatë kjo që reflekton në procesin e punës në institucion dhe shkallën e kënaqësisë nga ana e shfrytëzuesve. **Me qëllim të mbrojtjes dhe mbështetjes së vazhdueshme, në kohë, gjithpërfshirëse dhe efektive të shfrytëzuesve, është i nevojshëm plotësimi i përshpejtuar i vendeve të punës, veçanërisht sa i përket numrit të kujdestarëve, fizioterapistëve por edhe higjienistëve dhe shoferëve.**

Gjatë bisedës me të punësuarit në Ent, u theksua **nevoja për trajnime përpara përshirjes në procesin për ndihmë dhe mbështetje, përkatësisht para fillimit në vendin e punës, por edhe në mënyrë të vazhdueshme.** Nga inspektimi aktual i situatës, lirisht mund të konstatohet se ka mbulim të pamjaftueshëm të trajnimit, gjë që mund të konstatojmë pjesërisht edhe me informatat e marra nga shfrytëzuesit, përkatësisht, se një pjesë e të punësuarve nuk janë të senzibilizuar për punë për këtë profil të shfrytëzuesve, kështu shpesh shmangin detyrat e punës apo detyrimet, ose ia kalojnë detyrimin njeri-tjetrit. Informacionet nga shfrytëzuesit shkojnë aq larg sa të punësuarit përdorin fjalë nënçmuese dhe fyese ndaj shfrytëzuesve, të pakujdesshëm ndaj ekzekutimit të obligimeve të përditshme ose trajtimit joadekuat të shfrytëzuesve gjatë ofrimit të mbështetjes direkte, p.sh. gjatë larjes harxhohet ujë shumë i nxehtë, gjatë ushqimit përdoren lugët e njëjta nga më shumë shfrytëzues dhe ngjashëm. Për nevojën e kuadrove mirë të trajnuara dhe të senzibilizuara, në këtë lloj institucioni flasin dhe Standardet e Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Sjelljes jo Humane apo Degraduese ose Ndëshkuese, që i referohen një kuadri profesional, i cili mund të përshtatet dhe intervenojë në çdo situatë individuale të shfrytëzuesve të shërbimeve të institucionit⁶⁷.

Kjo mënyrë e sjelljes është në kundërshtim me Rregulloren e Shtëpisë së institucionit dhe Kodin e Sjelljes, që në mënyrë decide tregon sjelljen me respekt, durim dhe qëndrim profesional, si mes të punësuarve, ashtu edhe ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve në Ent.

Të gjithë shfrytëzuesit në institucion kanë mjekun amë. Një pjesë e shfrytëzuesve kanë zgjedhur me vullnetin e tyre apo me kërkesë të familjarëve të tyre, kurse për një pjesë më të madhe të shfrytëzuesve është përcaktuar mjek, i cili në institucion vjen dy herë në javë.

⁶⁶ Rregullorja për Organizim të brendshëm IP Entit për mbrojtje dhe rehabilitim - Banja Bansko numër 02-645/11 e datës 13.10.2015

⁶⁷ European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT), Persons deprived of their liberty in social care establishments, p. 2, e disponueshme në: <https://rm.coe.int/1680a0cc19> (Qasur nga data 05.04.2023)

Nga inspektimi i kushteve materiale në institucion, mund të konstatohet se sikurse objekti i ri, ashtu edhe ai i vjetri, janë objekte të qasur për persona me karroca dhe ndihmesa tjera shtesë.

Objekti i vjetër i Entit, edhe pse në përdorim që nga viti 1974, është në një gjendje relativisht të mirë, pastërti në nivel nëpër të gjitha hapësirat, dhomat e gjumit (një numër i madh me akomodim individual), janë të pajisura me pjesët e domosdoshme të mobiljeve; shtratë, sirtarë, dollape, byro dhe garderbë. Në disa hapësira kishte edhe televizor, por të njëjtin e kanë siguruar vet shfrytëzuesit dhe familjarët e tyre. Dhomat kanë ndriçim të mjaftueshëm përgjatë ditës, dhe të rregulluara me nxemje relativisht të mirë.

Në pjesën hyrëse të korridorit të objektit të vjetër, është vendosur një kuti për ankesa dhe kundërshtime.

Objekti i vjetër i Entit është i ndarë në dy pjesë, pjesa e meshkujve dhe pjesa e femrave, kurse mes tyre gjendet kuzhina dhe dhoma e ngrënies, por edhe zyrat e kuadrit profesional (punotërit social, psikologut).

